



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT

Nr. _____ prot.

Himarë , më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “NDËRTIMI I SHTEGUT TË ÇEZARIT”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45210000-2 -
Punime ndërtimi,**

**VLERA E FONDIT: 11 083 306,15 (njëmbëdhjetë milionë e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e
gjashtë pesje pesëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH**

Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, Inxhinieri është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti kontraktor: **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga organet kompetente, e cila duhet të përfshijë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- *NP-1A – Punime gjurmimi në tokë;*
- *NP-2A – Ndërtime civile dhe industriale*
- *NP-5A – Punime nëntokësore, ura e vepra arti*
- *NP-12 A – Punime të inxhinierisë së mjedisit.*

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- *NS-6A – Sinjalistika rrugore jo ndriçuese*
- *NS-7A – Barrierra dhe mbrojtje rrugore*
- *NS-8A – Ndërtime betonarme parafabrikat, struktura metalike*
- *NS-18A – Punime topogjeodezike.*

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, merr përsipër të realizojë.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose ministrisë kompetente të kohës) në Republikën e Shqipërisë, referuar VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, nenin 39, pika 6, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”, Ligjin Nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 të ndryshuar, VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar.

Në bazë të licencës profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që prokurohet dhe pikat e kërkuara të licensës janë përcaktuar nga vlera e punimeve që do të realizohen si dhe nisur nga natyra e punëve që do të kryhen sipas zërave të preventivit. Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 milion lekë për kategoritë e punimeve, është zgjedhur niveli i klasifikimit ”A” që i përgjigjet kësaj vlere.

Objekti përfshin një sërë punimesh të karakterit ndërtimor, infrastrukturor, hidroteknik, mjedisor, të sistemit të territorit dhe të sinjalistikës. Për realizimin e tij nuk mjafton vetëm kapaciteti për kryerjen e punimeve të zakonshme të ndërtimit, pasi gjatë zbatimit do të kryhen ndërhyrje në terren, punime gjurmimi dheu, formim dhe sistemim i shtratit të shtegut, realizim shtresash, punime betoni dhe betonarmeje, ndërtime veprash arti dhe kanalizimesh, muraturë guri, punime hidroizolimi dhe çatie, instalime hidro-sanitare, punime të karakterit mjedisor, sinjalistikë, tabela informuese dhe elementë të tjerë funksionalë të shtegut.

Për këtë arsye, kategoritë e licencës profesionale janë përcaktuar në funksion të drejtpërdrejtë të natyrës së punimeve që do të realizohen dhe jo në mënyrë të shkëputur nga objekti i kontratës.

Kërkesa për kategorinë NP-1A është e lidhur drejtpërdrejt me punimet e gjurmimit dhe përgatitjes së terrenit të parashikuara në preventiv. Në kuadër të ndërtimit të shtegut parashikohen punime gjurmimi, punime dheu, pastrimi dhe sistemimi i terrenit, si dhe pastrimi nga gurët dhe sistemimi i shtegut, përfshirë punime përpunimi dhe sheshimi. Këto punime janë procese bazë për krijimin e trupit dhe profilit të shtegut dhe përgatitjen e terrenit për shtresat dhe strukturat që do të vendosen më pas. Punimet e gjurmimit nuk kanë vetëm karakter sasior, por ndikojnë drejtpërdrejt në kuotat, pjerrësitë, gjerësinë dhe konfigurimin përfundimtar të shtegut. Realizimi i tyre në mënyrë të pasaktë mund të ndikojë në qëndrueshmërinë e shtresave, në largimin e ujërave dhe në funksionalitetin e të gjithë objektit. Për këtë arsye, kërkesa për NP-1A synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë kapacitetin profesional të nevojshëm për realizimin e punimeve të gjurmimit dhe përgatitjes së terrenit sipas projektit dhe specifikimeve teknike.

Kategoria NP-2A është e lidhur me komponentin kryesor ndërtimor të objektit dhe mbulon një numër të konsiderueshëm të proceseve të parashikuara në preventiv. Në objekt përfshihen punime betoni dhe betonarmeje, punime murature guri, punime hidroizolimi dhe çatie, struktura druri, si dhe punime të tjera ndërtimore që lidhen me realizimin e elementeve të objektit. Në veçanti, punimet e betonit dhe betonarmesë kërkojnë përgatitjen dhe vendosjen e materialeve, realizimin e elementeve konstruktive dhe respektimin e kërkesave teknike për qëndrueshmërinë e tyre. Në mënyrë të ngjashme, muratura e gurit kërkon përzgjedhjen dhe vendosjen e gurëve, realizimin e lidhjeve dhe fugave, si dhe respektimin e parametrave të projektuar të strukturës.

Për më tepër, punimet e hidroizolimit dhe çative, si dhe elementët prej druri, janë pjesë funksionale të strukturave të parashikuara dhe kërkojnë zbatim nga subjekt që disponon kapacitetin profesional përkatës. Për këtë arsye, NP-2A është e nevojshme për të mbuluar komponentin ndërtimor të objektit dhe për të garantuar që operatori ekonomik ka aftësinë profesionale për realizimin e këtyre punimeve.

Kategoria NP-5A është përcaktuar për shkak të përfshirjes në preventiv të grupit të punimeve “Ndërtimi i veprave të artit + kanalizime”, si dhe të punimeve të betonit dhe betonarmesë që lidhen me këto ndërhyrje. Në një shteg të realizuar në terren natyror, menaxhimi i ujërave sipërfaqësore është një element i rëndësishëm për qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e veprës. Për këtë arsye, ndërtimi i veprave të artit dhe kanalizimeve ka funksionin e kontrollit, përcjelljes dhe largimit të ujërave dhe të mbrojtjes së trupit të shtegut nga dëmtimet që mund të shkaktohen nga ujërat atmosferike. Punimet e tilla mund të përfshijnë ndërhyrje në terren, gjurmime, përgatitje të bazamentit, realizim elementësh prej betoni dhe betonarmeje, ndërtim kanalesh dhe elementësh të tjerë të përcaktuar në projekt. Për këtë arsye, NP-5A lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me një komponent të veçantë dhe të rëndësishëm të objektit dhe është e nevojshme për garantimin e kapacitetit profesional për realizimin e veprave të artit dhe kanalizimeve.

Kategoria NP-12A lidhet me karakterin mjedisor të objektit dhe me ndërhyrjet që do të kryhen në një territor me karakter natyror. Në preventiv janë parashikuar punime shpyllëzimi, pastrime, dezinfektim, pastrim nga gurët, sistemim i terrenit dhe mirëmbajtje vjetore. Këto punime kanë lidhje të drejtpërdrejtë me përgatitjen, sistemimin dhe mirëmbajtjen e territorit ku shtrihet shtegu. Punimet e shpyllëzimit dhe pastrimit duhet të kryhen në mënyrë të kontrolluar, duke shmangur ndërhyrjet e panevojshme jashtë gjurmës së projektuar. Po kështu, pastrimi dhe sistemimi i territorit pas përfundimit të punimeve janë të nevojshme për rikthimin e funksionalitetit dhe të paraqitjes së përshtatshme të zonës. Përfshirja e NP-12A lidhet, në këtë kuadër, me nevojën për të mbuluar komponentin mjedisor dhe të sistemimit të territorit të objektit.

Kategoria NS-6A është përcaktuar në funksion të punimeve të sinjalistikës dhe informimit të përdoruesve të shtegut. Në preventiv janë parashikuar tabela informuese, panele plotësuese sinjalistike, si dhe dizajn i tabelave dhe paneleve. Këto elemente janë pjesë e funksionit të shtegut dhe kanë për qëllim orientimin, informimin dhe sigurimin e përdoruesve gjatë lëvizjes në të. Vendosja e sinjalistikës duhet të bëhet në pozicionet e përcaktuara nga projekti dhe sipas kërkesave teknike përkatëse, në mënyrë që informacioni të jetë i dukshëm, i kuptueshëm dhe funksional. Për këtë arsye, kërkesa për NS-6A është e lidhur me komponentin e sinjalistikës jo ndriçuese të përfshirë në preventiv dhe me nevojën për realizimin e tij nga operator me kapacitetin profesional përkatës.

Kategoria NS-7A lidhet me aspektin e sigurisë dhe mbrojtjes së përdoruesve dhe të vetë infrastrukturës së shtegut. Duke qenë se objekti zhvillohet përgjatë një terreni natyror, me ndryshime të kuotave dhe karakteristika të ndryshme të terrenit, në segmente të caktuara mund të jetë e nevojshme vendosja e elementeve mbrojtëse dhe kufizuese, sipas zgjidhjeve të përcaktuara në projekt. Elementet e mbrojtjes kanë rëndësi jo vetëm për sigurinë e përdoruesve, por edhe për mbrojtjen e strukturës së shtegut dhe të segmenteve të tij nga dëmtimet që mund të shkaktohen nga kushtet e terrenit. Për këtë arsye, NS-7A lidhet me komponentin e mbrojtjes dhe sigurisë së infrastrukturës dhe me kapacitetin për realizimin e elementeve mbrojtëse të parashikuara në projekt.

Kategoria NS-8A lidhet me nevojën për realizimin dhe montimin e elementeve strukturore të përfshira në objekt. Në preventiv janë parashikuar struktura druri dhe elementë të tjerë konstruktivë që kërkojnë përgatitje, montim, fiksime dhe integrim me pjesët e tjera të objektit. Këto procese kërkojnë respektimin e kërkesave të projektit për dimensionet, lidhjet, fiksime dhe qëndrueshmërinë e strukturave. Për këtë arsye, kërkesa për kategorinë përkatëse të licencës synon të sigurojë që operatori ekonomik të disponojë kapacitetin profesional për realizimin e komponentëve strukturore të objektit.

Kategoria NS-18A është e nevojshme për shkak të karakterit linear të objektit dhe ndërhyrjeve që do të kryhen në një terren natyror me ndryshime të kuotave. Gjatë zbatimit të shtegut është e nevojshme përcaktimi dhe kontrolli i aksit të shtegut, kuotave, niveleve, pjerrësive, profileve dhe pozicionimit të veprave të artit dhe elementeve të tjera ndërtimore. Punimet topogjeodezike janë të rëndësishme në fazën e piktimit, gjatë zbatimit dhe në kontrollin e pozicionit përfundimtar të punimeve. Ato sigurojnë që ndërhyrjet në terren të kryhen në përputhje me projektin dhe që të respektohen parametrat gjeometrikë të përcaktuar. Në një objekt të tillë, ku shtegu shtrihet në terren me konfigurim të ndryshueshëm dhe ku realizohen njëkohësisht punime dheu, shtresash, vepra arti dhe elementë të tjerë, kontrolli topografik është një proces i domosdoshëm për cilësinë dhe saktësinë e zbatimit.

Përcaktimi i kategorive është bërë mbi bazën e lidhjes së drejtpërdrejtë midis objektit të kontratës dhe natyrës së punimeve që do të realizohen, me synim garantimin e kapacitetit profesional dhe teknik të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës dhe jo për të vendosur kërkesa të shkëputura nga objekti.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kërkesa që secili anëtar të paraqesë kategoritë përkatëse të licencës sipas pjesës së punimeve që merr përsipër të realizojë, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, siguron që çdo pjesë e kontratës të mbulohet nga subjekti që disponon kapacitetin dhe autorizimin profesional përkatës.

Për operatorët ekonomikë të huaj, kërkesa për ekuivalentimin e licencave profesionale të lëshuara nga vendi i origjinës pranë institucionit kompetent në Republikën e Shqipërisë është përcaktuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator shqiptar për licencimin profesional të subjekteve që ushtrojnë veprimtari ndërtimi.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci e

tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...”; nenin 43 pika 2/c dhe pika 3, nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohen se:

“2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme”.

“3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

“Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron është vendosur konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për:

- një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 29 % e vlerës së përllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 95 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore si dhe me situacionet e punimeve dhe akt-kolaudimin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku parashikohet se ”Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Referuar nenit 55 pika 4 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, është përcaktuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Përcaktimi i vlerës minimale prej 95% të vlerës limit të kontratës synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë një eksperiencë reale dhe të konsoliduar në realizimin e punimeve të ngjashme,

në një volum ekonomik të konsiderueshëm dhe të krahasueshëm me përmasat e kontratës objekt prokurimi. Ky nivel kërkesë është i arsyeshëm duke pasur parasysh se kontrata përfshin një kombinim të punimeve të prishjes, gërmimit, transportit, ndërtimit të shtresave konstruktive, betonimit dhe shtrimit të sipërfaqeve me gur natyral.

Kërkesa është vendosur duke respektuar përcaktimin ligjor sipas të cilit, për kontratat e punëve në procedurat e thjeshtuara, vlera e punëve të ngjashme të kërkuara në total gjatë pesë viteve të fundit nuk duhet të jetë më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Në rastin konkret, kërkesa prej 95% është më e ulët se kufiri maksimal prej 100% të vlerës limit të kontratës dhe, për rrjedhojë, qëndron brenda kufirit të përcaktuar nga kuadri ligjor.

Në përputhje me përcaktimin ligjor, kriteri është konceptuar në mënyrë alternative, duke parashikuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve të përvojës së ngjashme e bën ofertën të kualifikueshme. Për rrjedhojë, operatorët ekonomikë kanë mundësi të dëshmojnë kapacitetin e tyre profesional ose nëpërmjet realizimit të një pune të ngjashme për një objekt të vetëm, brenda kufirit të përcaktuar përkatësisht nga legjislacioni, ose nëpërmjet realizimit të disa punëve të ngjashme, vlera monetare totale e të cilave plotëson pragun e kërkuar.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë personelin kryesor drejtues teknik, të përshtatshëm për realizimin e objektit të kontratës, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën profesionale të shoqërisë, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, si dhe të figurojë në listëpagesën e operatorit ekonomik për muajin Korrik 2026, si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi;
- 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet/markshajder.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentacionin që provon kualifikimin profesional dhe marrëdhënien e punës së personave të deklaruar, konkretisht: diplomë, kontratë pune, CV dhe, sipas rastit, librezë pune ose dokumentacion tjetër të barasvlershëm që provon eksperiencën dhe marrëdhënien e punës.

Disponimi i personelit të kërkuar do të deklarohet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për

përmbushjen e këtyre kritereve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Kërkesa për disponimin e personelit kryesor drejtues teknik lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të parashikuara në preventiv si dhe me kategoritë e licencës së kërkuar për zbatimin e punimeve objekt kontrate. Objekti përmban një kombinim të konsiderueshëm procesesh ndërtimore dhe infrastrukturore, ku përfshihen punime shpyllëzimi, gjurmime, punime dheu dhe shtresash, punime betoni dhe betonarmeje, muraturë guri, hidroizolime dhe çati, instalime hidro-sanitare, ndërtim veprash arti dhe kanalizime, struktura druri, sinjalistikë dhe tabela informuese, si dhe punime të pastrimit, sistemimit dhe mirëmbajtjes së shtegut. Për shkak të kësaj natyre të kombinuar të objektit, është e nevojshme që gjatë zbatimit të kontratës të garantohet drejtimi teknik dhe kontrolli profesional i punimeve ndërtimore, si dhe kontrolli topografik i pozicionimit dhe parametrave gjeometrikë të shtegut dhe veprave të tij. Kërkesa për dy profilet e mësipërme është përcaktuar në mënyrë proporcionale me natyrën e punimeve dhe synon të garantojë kontrollin e dy komponentëve kryesorë të zbatimit: komponentit teknik/ndërtimor dhe komponentit topografik/gjeometrik.

Kërkesa për disponimin e 1 (një) inxhinieri ndërtimi është e lidhur drejtpërdrejt me kompleksitetin e punimeve ndërtimore dhe strukturore të parashikuara në preventiv. Në kuadër të objektit parashikohen punime gjurmimi, punime dheu, punime shtresash, punime betoni dhe betonarmeje, punime murature guri, punime hidroizolimi dhe çatie, ndërtimi i veprave të artit dhe kanalizimeve, struktura druri, si dhe punime të tjera që kërkojnë kontroll dhe drejtim teknik gjatë zbatimit. Inxhinieri i ndërtimit është i nevojshëm për të garantuar drejtimin dhe mbikëqyrjen teknike të këtyre proceseve, duke siguruar që punimet të realizohen në përputhje me projektin e miratuar, specifikimet teknike, preventivin, kushtet teknike të zbatimit dhe kërkesat e sigurisë.

Në mënyrë më specifike, prania e inxhinierit të ndërtimit është e nevojshme për:

- Punimet e gjurmimit dhe punimet e dheut, ku kërkohet kontrolli i përgatitjes së terrenit, kuotave të realizuara, qëndrueshmërisë së zonave të gjermuara dhe përputhjes së punimeve me zgjidhjen teknike të projektit.
- Punimet e shtresave, ku kërkohet kontrolli i përgatitjes së bazamentit, materialeve të përdorura, trashësive dhe mënyrës së realizimit të shtresave, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria dhe funksionaliteti i shtegut.
- Punimet e betonit dhe betonarmesë, të cilat kërkojnë kontroll të formave, armaturave, vendosjes së betonit, dimensioneve dhe parametrave teknikë të elementeve konstruktive, si dhe kontrollin e materialeve dhe mënyrës së zbatimit.
- Punimet e muraturës së gurit, ku kërkohet kontrolli i mënyrës së vendosjes së gurëve, lidhjes së tyre, përdorimit të llaçit, trashësive dhe dimensioneve të strukturave, si dhe përputhjes së tyre me projektin.
- Ndërtimin e veprave të artit dhe kanalizimeve, ku kërkohet kontroll teknik i gjurmimeve, bazamentit, dimensioneve, elementeve prej betoni/betonarmeje dhe mënyrës së realizimit të strukturave që kanë funksion mbajtës ose të përcjelljes së ujërave.

- Punimet e hidroizolimit dhe çative, për të siguruar që materialet dhe mënyra e aplikimit të jenë në përputhje me specifikimet teknike dhe të garantojnë mbrojtjen e strukturave nga depërtimi i ujit.

- Strukturat e drurit dhe elementët konstruktivë, ku kërkohet kontrolli i dimensioneve, lidhjeve, fiksimeve dhe qëndrueshmërisë së tyre.

- Përveç kontrollit të proceseve të veçanta, inxhinieri i ndërtimit do të ketë rol në koordinimin teknik të proceseve të ndryshme, pasi punimet e objektit nuk realizohen në mënyrë të shkëputur, por në një rend të caktuar teknologjik. Për shembull, punimet e gërmimit dhe sistemimit të terrenit paraprijnë realizimin e shtresave, ndërsa veprat e artit dhe kanalizimet duhet të koordinohen me kuotat dhe konfigurimin përfundimtar të shtegut.

Për këtë arsye, kërkesa për 1 (një) inxhinier ndërtimi është e nevojshme për drejtimin dhe kontrollin teknik të komponentit kryesor ndërtimor të kontratës.

Kërkesa për 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet/markshajder lidhet drejtpërdrejt me karakterin linear të objektit dhe faktin se “Shtegu i Çezarit” realizohet në një territor natyror, ku ekzistojnë ndryshime të kuotave, pjerrësi dhe konfigurime të ndryshme të terrenit. Punimet e parashikuara në preventiv kërkojnë përcaktim të saktë të pozicionit dhe parametrave gjeometrikë të shtegut. Për këtë arsye, kontrolli topografik është i nevojshëm gjatë fazave të ndryshme të zbatimit.

Inxhinieri topograf/gjeodet/markshajder është i nevojshëm për:

- Piketimin e aksit të shtegut, duke përcaktuar në terren pozicionin e saktë të gjurmës së projektuar.

- Përcaktimin dhe kontrollin e kuotave, në mënyrë që gërmimet, mbushjet, shtresat dhe elementët e tjerë të realizohen sipas niveleve të përcaktuara në projekt.

- Kontrollin e pjerrësive dhe profileve të shtegut, veçanërisht për shkak të karakterit të terrenit dhe nevojës për respektimin e parametrave të projektuar.

- Piketimin e veprave të artit dhe kanalizimeve, në mënyrë që pozicioni, drejtimi, kuotat dhe lidhja e tyre me shtratin e shtegut të jenë në përputhje me projektin.

- Kontrollin e shtresave dhe niveleve të përfunduara, për të verifikuar që kuotat e realizuara përfundimisht janë në përputhje me ato të projektit.

- Përcaktimin e kufijve dhe gjurmës së ndërhyrjes, me qëllim që punimet e shpyllëzimit, pastrimit, gërmimit dhe sistemimit të kryhen brenda zonës së përcaktuar dhe të shmangen ndërhyrjet e panevojshme në territor.

- Kontrollin e pozicionit të elementeve të sinjalistikës dhe tabelave, kur këto elemente kanë pozicione të përcaktuara në projekt ose në planin e sistemimit të shtegut.

Roli i këtij specialisti është veçanërisht i rëndësishëm për shkak se gabimet në piketim ose në përcaktimin e kuotave mund të ndikojnë në mënyrë zinxhir në punimet pasuese. Një pasaktësi në aksin ose kuotën e shtegut mund të sjellë devijime në gërmime, shtresa, vepra arti, kanalizime dhe në elementët e tjerë të objektit. Për këtë arsye, disponimi i 1 (një) inxhinieri topograf/gjeodet/markshajder është i nevojshëm për të garantuar saktësinë gjeometrike të zbatimit të punimeve dhe për të siguruar që ato të realizohen në përputhje me projektin.

Dy profilet e kërkuara nuk kanë funksione të njëjta dhe plotësojnë njëri-tjetrin në procesin e zbatimit të kontratës. Inxhinieri i ndërtimit siguron drejtimin dhe kontrollin e proceseve ndërtimore, konstruktive dhe të sistemimit të strukturave, ndërsa inxhinieri topograf/gjeodet/markshajder siguron saktësinë e pozicionimit, kuotave, niveleve, profileve dhe parametrave gjeometrikë. Koordinimi ndërmjet tyre është veçanërisht i rëndësishëm për këtë

objekt, pasi punimet e gërmimit, shtresave, veprave të artit, kanalizimeve dhe strukturave duhet të realizohen mbi bazën e kuotave dhe pozicioneve të përcaktuara topografikisht. Në këtë mënyrë, kërkesa për këto dy profile siguron një ndarje të qartë dhe funksionale të përgjegjësisve teknike dhe mbulon dy nevojat themelore të zbatimit të objektit: kontrollin teknik të punimeve dhe kontrollin topografik të tyre.

Kërkesa që personeli i deklaruar të figurojë në listëpagesën e operatorit ekonomik për muajin Korrik 2026 është vendosur me qëllim që disponimi i personelit të mos jetë vetëm deklarativ, por të provohet ekzistenca e një marrëdhënieje reale pune me operatorin ekonomik në periudhën e përcaktuar. Duke qenë se personeli i kërkuar përbën personelin kryesor drejtues teknik të kontratës, verifikimi i marrëdhënies së punës siguron që operatori ekonomik ka në dispozicion specialistët e nevojshëm për organizimin dhe drejtimin e punimeve. Kërkesa për këtë dokumentacion duhet të vlerësohet së bashku me Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionin provues të kërkuar, sipas përcaktimeve të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë punonjës teknikë dhe të specializuar, të kualifikuar për kryerjen e proceseve të ndryshme të punimeve objekt kontrate dhe të pajisur, sipas profesionit, me diplomë, dëshmi kualifikimi, certifikatë profesionale ose dokument tjetër të vlefshëm të lëshuar nga institucionet/organizmat kompetentë, si më poshtë:

- 2 (dy) teknikë ndërtimi;
- 1 (një) elektrikist;
- 1 (një) punonjës hidraulik;
- 2 (dy) punonjës betonues;
- 2 (dy) punonjës hekurthyes;
- 2 (dy) punonjës murator/suvatues;
- 2 (dy) punonjës karpentier;
- 2 (dy) punonjës për konstruksione metalike/montator;
- 2 (dy) punonjës të kualifikuar për punime në lartësi;
- 2 (dy) drejtues të mjeteve/makinerve të rënda, të kualifikuar për drejtimin e mjeteve përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi;
- 2 (dy) shoferë, të pajisur me leje drejtimi të kategorisë përkatëse, përfshirë kategorinë B, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Personeli i mësipërm duhet të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik për muajin Korrik 2026. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë disponimin e personelit të kërkuar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë,

përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit” si dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", Urdhërin Nr. 109, datë 05.08.2013 ”Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, pasi për kryerjen e punimeve të veçanta sipas zërave të preventivit kërkohen specialistët e sipërpërmendur. Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve, volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike.

Kërkesa për numrin dhe profilet e punonjësve është përcaktuar në mënyrë të lidhur me proceset konkrete të preventivit, si më poshtë.

Kërkesa për 2 (dy) teknikë ndërtimi lidhet me nevojën për organizimin dhe kontrollin e vazhdueshëm të proceseve të ndryshme të punës në terren. Teknikët e ndërtimit shërbejnë si personel teknik mbështetës për drejtimin e punimeve dhe koordinimin e ekipeve të punëtorëve, duke ndjekur zbatimin e detajeve teknike, rendin teknologjik dhe organizimin e kantierit. Në këtë objekt, ku ndërthuren punime gërmimi, sistemimi, shtresash, betoni, murature, vepra arti dhe punime të tjera, prania e dy teknikëve mundëson mbulimin e njëkohshëm të proceseve të ndryshme dhe ndjekjen e tyre në terren. Numri 2 (dy) është përcaktuar si minimum i arsyeshëm për të garantuar mbështetje teknike në segmentet ose proceset e ndryshme të punimeve.

Kërkesa për 1 (një) elektrikist lidhet me punimet dhe instalimet elektrike që mund të nevojiten në kuadër të komponentëve funksionalë të objektit, veçanërisht në lidhje me elementët informues, sinjalistikën dhe instalimet e nevojshme për funksionimin e komponentëve të parashikuar në projekt. Elektricisti siguron realizimin, kontrollin dhe mirëmbajtjen e instalimeve elektrike që kërkojnë ndërhyrje profesionale, si dhe garanton që çdo punim elektrik të kryhet në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me kërkesat teknike. Duke qenë se nevoja për punime elektrike është e kufizuar në krahësim me punimet e përgjithshme të objektit, kërkesa për 1 (një) elektrikist konsiderohet e mjaftueshme dhe proporcionale.

Kërkesa për 1 (një) punonjës hidraulik lidhet drejtpërdrejt me grupin e punimeve “instalime hidro-sanitare dhe ngrohje” të përfshirë në preventiv. Punonjësi hidraulik është i nevojshëm për realizimin dhe montimin e tubacioneve, rakorderive, lidhjeve dhe elementëve të instalimeve hidro-sanitare, si dhe për kryerjen e provave dhe kontrolleve përkatëse. Për shkak se punimet hidro-sanitare përbëjnë një komponent specifik të objektit dhe nuk shtrihen në të njëjtën masë si punimet

e përgjithshme ndërtimore, numri 1 (një) është përcaktuar si minimumi i nevojshëm për këtë proces.

Kërkesa për 2 (dy) punonjës betonues lidhet me zërat e shumtë të preventivit që përfshijnë punime betoni dhe betonarmeje, si dhe me ndërtimin e veprave të artit dhe elementëve të tjera prej betoni. Betonuesit janë të nevojshëm për përgatitjen, transportimin brenda kantierit, vendosjen, shpërndarjen, vibrimin dhe përpunimin e betonit sipas kërkesave teknike. Dy punonjës mundësojnë realizimin e proceseve të betonimit në bashkëpunim me punonjësit e armaturës dhe karpentierët, duke siguruar një organizim të përshtatshëm të procesit dhe respektimin e rendit teknologjik. Numri 2 (dy) lidhet me nevojën për realizimin e punimeve të betonit në procese që mund të zhvillohen në segmente të ndryshme të objektit.

Kërkesa për 2 (dy) punonjës hekurthyes lidhet me punimet e betonarmesë të parashikuara në preventiv dhe veçanërisht me realizimin e elementëve strukturorë të veprave të artit dhe ndërtimeve të tjera prej betonarmeje. Hekurthyesit janë përgjegjës për përgatitjen, prerjen, përkuljen, montimin dhe lidhjen e armaturës sipas detajeve të projektit. Puna e tyre duhet të kryhet përpara betonimit dhe në koordinim të drejtpërdrejtë me betonuesit dhe karpentierët. Për këtë arsye, disponimi i dy punonjësve mundëson realizimin paralel të përgatitjes së armaturës dhe proceseve të betonimit. Numri 2 (dy) është përcaktuar si minimum i nevojshëm për proceset e betonarmesë të përfshira në objekt.

Kërkesa për 2 (dy) punonjës murator/suvatues lidhet me punimet e muraturës së gurit dhe punimet e tjera të përfundimit të sipërfaqeve të parashikuara në preventiv. Punimet e muraturës së gurit kërkojnë punonjës të specializuar për përzgjedhjen, vendosjen dhe lidhjen e gurëve, përgatitjen dhe përdorimin e llaçit, realizimin e fugave dhe respektimin e dimensioneve të strukturave. Në varësi të elementëve të projektuar, punonjësit mund të angazhohen gjithashtu në punime përgatitore dhe përfundimtare të sipërfaqeve.

Dy punonjës sigurojnë mundësinë e realizimit të këtij procesi në mënyrë të vazhdueshme dhe në koordinim me proceset e tjera ndërtimore.

Kërkesa për 2 (dy) punonjës karpentier lidhet me punimet që kërkojnë përdorimin e konstruksioneve dhe elementëve prej druri, si dhe me punimet për kallëpet e elementëve prej betoni dhe betonarmeje. Karpentierët janë të nevojshëm për përgatitjen, montimin dhe çmontimin e kallëpeve, si dhe për realizimin dhe montimin e elementëve prej druri të parashikuar në projekt. Duke qenë se procesi i kallëpimit është i lidhur drejtpërdrejt me punimet e betonit dhe betonarmesë, disponimi i dy karpentierëve mundëson koordinimin e këtyre dy proceseve dhe shmang vonesat në ciklin teknologjik të betonimit.

Kërkesa për 2 (dy) punonjës të kualifikuar për konstruksione metalike/montator lidhet me realizimin dhe montimin e elementëve konstruktivë dhe metalikë që mund të përfshihen në komponentët funksionalë dhe strukturorë të objektit. Këta punonjës janë të nevojshëm për përgatitjen, montimin, fiksimin dhe pozicionimin e elementëve konstruktivë, sipas detajeve të projektit dhe specifikimeve teknike. Dy punonjës janë të nevojshëm për të mundësuar realizimin e punimeve të montimit në mënyrë të sigurt dhe për të krijuar një ekip pune të përshtatshëm për manipulimin dhe pozicionimin e elementëve.

Kërkesa për 2 (dy) punonjës të kualifikuar për punime në lartësi lidhet me punimet që mund të kërkojnë ndërhyrje në kuota të ngritura, veçanërisht në lidhje me punimet e çative, strukturave, montimit dhe elementëve të tjerë të objektit që nuk mund të realizohen nga niveli i tokës. Punimet në lartësi paraqesin rrezik të shtuar dhe kërkojnë personel të trajnuar dhe të kualifikuar për këtë

lloj pune, si dhe përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të përshtatshme të mbrojtjes. Kërkesa për dy punonjës siguron që të mund të krijohet një ekip pune i aftë për kryerjen e proceseve në lartësi dhe për të respektuar kërkesat e sigurisë në punë.

Kërkesa për 2 (dy) drejtues të mjeteve/makinerive të rënda, të kualifikuar për drejtimin e mjeteve përkatëse, lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të gërmimit, punimeve të dheut, pastrimit nga gurët dhe sistemimit/sheshimit të shtegut. Këto procese kërkojnë përdorimin e makinerive të përshtatshme për punimet e terrenit dhe për transportin/manipulimin e materialeve. Disponimi i dy drejtuesve krijon mundësinë e operimit të mjeteve dhe makinerive të ndryshme në mënyrë të koordinuar, sipas fazave të punimeve, duke shmangur varësinë e të gjithë procesit nga një drejtues i vetëm. Kërkesa lidhet gjithashtu me nevojën që drejtuesit të jenë të pajisur me dokumentacionin dhe kualifikimin përkatës sipas llojit të mjetit ose makinerisë që do të drejtojnë.

Kërkesa për 2 (dy) shoferë, të pajisur me leje drejtimi të kategorisë përkatëse, përfshirë kategorinë B, lidhet me nevojën për transportin dhe lëvizjen e materialeve, pajisjeve, mjeteve të punës dhe personelit gjatë zbatimit të kontratës. Preventivi përfshin punime që gjenerojnë materiale të gërmuara dhe mbetje, si dhe kërkojnë furnizimin e kantierit me materiale ndërtimore, elementë të ndryshëm dhe pajisje. Për këtë arsye, disponimi i dy shoferëve siguron fleksibilitet në transportin e materialeve dhe mbështetjen logjistike të kantierit, duke bërë të mundur që transporti të zhvillohet paralelisht me proceset e punës. Kërkesa që shoferët të jenë të pajisur me lejen e drejtimit të kategorisë përkatëse siguron që drejtimi i mjeteve të kryhet nga persona të autorizuar dhe të kualifikuar sipas legjislacionit në fuqi.

Kërkesat për personelin teknik dhe të specializuar janë të lidhura me grupet e punimeve të parashikuara në preventiv si më poshtë:

- Punimet e gërmimit, punimet e dheut, pastrimi nga gurët dhe sistemimi/sheshimi i shtegut kërkojnë teknikë ndërtimi dhe drejtues të mjeteve/makinerive të rënda.
- Punimet e shtresave, betonit dhe betonarmesë dhe veprat e artit kërkojnë teknikë ndërtimi, betonues, hekurthyes dhe karpentierë.
- Punimet e muraturës së gurit kërkojnë muratorë/suvatues.
- Punimet hidro-sanitare dhe të ngrohjes kërkojnë hidraulik.
- Punimet dhe instalimet elektrike kërkojnë elektrikist.
- Punimet e strukturave dhe elementëve konstruktivë kërkojnë karpentierë dhe punonjës për konstruksione metalike/montatorë.
- Punimet e çative dhe elementët që realizohen në kuota të ngritura kërkojnë punonjës të kualifikuar për punime në lartësi.
- Transporti i materialeve, pajisjeve dhe mbetjeve kërkon shoferë dhe drejtues të mjeteve përkatëse.

Kjo lidhje tregon se profilet e kërkuara nuk janë të shkëputura nga objekti i kontratës, por janë përcaktuar në funksion të proceseve konkrete të zbatimit.

Kërkesa që çdo punonjës të jetë i pajisur, sipas profesionit, me diplomë, dëshmi kualifikimi, certifikatë profesionale ose dokument tjetër të vlefshëm të lëshuar nga institucionet/organizmat kompetentë, është e nevojshme për të siguruar që personeli i deklaruar ka aftësitë profesionale të përshtatshme për procesin e punës që do të kryejë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për profesionet dhe funksionet që kërkojnë kualifikim të posaçëm, si drejtuesit e mjeteve dhe makinerive, shoferët, punonjësit e specializuar dhe personeli që kryen punime në lartësi. Dokumentacioni profesional shërben për të provuar që personeli i deklaruar nuk është vetëm i

disponueshëm formalisht, por ka edhe kualifikimin e nevojshëm për kryerjen e punës për të cilën është deklaruar.

Kërkesa që personeli i mësipërm të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik për muajin Korrik 2026 është vendosur për të provuar disponimin real të fuqisë punëtore dhe për të garantuar që operatori ekonomik ka në dispozicion personelin e specializuar të deklaruar. Duke qenë se punonjësit e kërkuar janë të lidhur me procese konkrete të zbatimit të objektit, verifikimi i marrëdhënies së punës siguron që operatori ekonomik nuk mbështetet vetëm në deklarime, por disponon realisht burimet njerëzore të nevojshme për realizimin e kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë personel mbështetës të kualifikuar, të përshtatshëm për natyrën dhe kompleksitetin e punimeve objekt kontrate, të pajisur, sipas rastit, me diplomë, dëshmi/certifikatë kualifikimi ose trajnimi të lëshuar nga institucionet apo organizmat kompetentë dhe të vlefshme sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për muajin Korrik 2026, si më poshtë:

a) 1 (një) punonjës i certifikuar me dëshmi trajnimi si “Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë”, të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, disponimi i këtij specialisti do të vlerësohet në përputhje me pjesën e punimeve që secili anëtar merr përsipër të realizojë, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

b) 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, të lëshuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar, subjekte të akredituara ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

c) 1 (një) punonjës i certifikuar si “Ekspert Zjarrfikës” në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, i pajisur me dokumentacionin/certifikatën përkatëse të lëshuar nga organi kompetent, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë, sipas rastit, dokumentet që provojnë marrëdhënien e punës, kualifikimin dhe certifikimin e personelit të kërkuar.

Disponimi i personelit të kërkuar do të deklarohet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë

19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit*”

Preventivi përfshin një kombinim të gjerë punimesh, ndër të cilat punime shpyllëzimi, gërmimi, punime dheu dhe sistemimi të terrenit, punime shtresash, punime betoni dhe betonarmeje, muraturë guri, punime hidroizolimi dhe çatie, instalime hidro-sanitare, ndërtim veprash arti dhe kanalizime, struktura druri, punime dhe montime të elementeve konstruktive, punime në lartësi, sinjalistikë, pastrime dhe mirëmbajtje. Këto procese shoqërohen me rreziqe të ndryshme profesionale dhe operacionale, si rreziku nga makineritë e rënda, gërmimet dhe materialet e paqëndrueshme, puna në lartësi, përdorimi i mjeteve elektrike dhe pajisjeve të punës, manipulimi i materialeve, betonimi dhe montimi i elementeve konstruktive, si dhe rreziku i zjarrit apo i dëmtimeve gjatë aktivitetit në kantier.

Për këtë arsye, është vlerësuar e nevojshme disponimi i tre profileve të specializuara mbështetëse, të cilat mbulojnë tre fusha të ndryshme dhe plotësuese: sigurinë dhe shëndetin në punë, ndihmën e parë dhe emergjencat mjekësore, si dhe mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

Kërkesa për 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë” lidhet drejtpërdrejt me natyrën e proceseve të punës që do të zhvillohen në kantier. Objekti përfshin procese me shkallë të ndryshme rreziku, duke përfshirë gërmimet, përdorimin e makinerive të rënda, transportin e materialeve, punimet e betonit dhe betonarmesë, punimet e muraturës, punimet e çative dhe strukturave, punimet në lartësi, montimin e elementeve konstruktive dhe ndërhyrjet në terren natyror.

Në këto kushte, është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë një person të specializuar që ndjek dhe mbështet zbatimin e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë gjithë procesit të realizimit të kontratës. Specialisti për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë është i nevojshëm për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që lidhen me proceset e punës, si dhe për ndjekjen e masave parandaluese për shmangien e aksidenteve.

Në mënyrë konkrete, nevoja për këtë profil lidhet me:

- Punimet e gërmimit dhe të dheut, ku ekzistojnë rreziqe nga shembja ose rrëshqitja e materialeve, përdorimi i makinerive dhe qëndrimi i punonjësve pranë zonave të gërmuara.
- Përdorimin e makinerive dhe mjeteve të rënda, ku kërkohet ndarja dhe organizimi i zonave të punës dhe kontrolli i respektimit të procedurave të sigurisë.
- Punimet e betonit dhe betonarmesë, ku përdoren armatura, kallëpe, mjete pune dhe pajisje që mund të krijojnë rrezik për punonjësit.
- Punimet në lartësi, veçanërisht në lidhje me çatitë, strukturat dhe elementët konstruktivë, ku ekziston rreziku i rënies nga lartësia.
- Punimet e montimit dhe konstruksioneve, ku ekzistojnë rreziqe gjatë ngritjes, manipulimit dhe fiksimit të elementeve.
- Punimet elektrike dhe hidro-sanitare, të cilat kërkojnë respektimin e masave specifike të sigurisë gjatë ndërhyrjeve.
- Punimet në terren natyror, ku kushtet e terrenit, pjerrësitë, gurët dhe ndryshimet e kuotave mund të krijojnë rreziqe shtesë për punonjësit.

Specialisti ka gjithashtu rol në ndërgjegjësimin e punonjësve, përdorimin korrekt të pajisjeve individuale dhe kolektive të mbrojtjes dhe ndjekjen e masave parandaluese gjatë realizimit të

proceseve të ndryshme. Kërkesa për 1 (një) specialist konsiderohet e përshtatshme si minimum për këtë funksion, pasi bëhet fjalë për një funksion mbështetës që mbulon të gjithë organizimin e sigurisë në kantier dhe nuk kërkon vendosjen e specialistëve të shumtë për të njëjtin funksion.

Kërkesa për 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” është përcaktuar për të garantuar kapacitetin e menjëhershëm të reagimit në rast dëmtimi, aksidenti ose situatë emergjente gjatë punimeve. Natyra e objektit dhe proceset e ndryshme që do të zhvillohen në terren mund të krijojnë situata që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, përpara mbërritjes së shërbimeve të specializuara.

Rreziku mund të lidhet me:

- a) dëmtime gjatë përdorimit të makinerive dhe mjeteve të punës;
- b) rrëzime ose goditje gjatë punimeve në lartësi;
- c) dëmtime gjatë punimeve të gërmimit;
- d) prerje ose dëmtime gjatë përpunimit dhe montimit të armaturave;
- e) dëmtime gjatë manipulimit të materialeve;
- f) goditje ose dëmtime gjatë punimeve të betonit dhe strukturave;
- g) aksidente gjatë transportit dhe lëvizjes së mjeteve në kantier;
- h) situata të tjera të paparashikuara që mund të kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme.

Disponimi i një personi të trajnuar për ndihmën e parë siguron që në rast incidenti të mund të jepet ndihma fillestare në mënyrë të organizuar dhe të përshtatshme deri në marrjen e ndihmës nga strukturat kompetente shëndetësore. Kërkesa për 1 (një) ekspert është proporcionale me nevojën e objektit, pasi qëllimi nuk është krijimi i një strukture të veçantë shëndetësore në kantier, por garantimi i pranisë së një personi të kualifikuar për reagimin fillestar ndaj emergjencave.

Kërkesa për 1 (një) punonjës të certifikuar si “Ekspert Zjarrfikës” në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit lidhet me nevojën për parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut nga zjarri gjatë realizimit të punimeve. Edhe pse objekti është kryesisht një shteg në terren natyror, gjatë zbatimit përdoren mjete, makineri dhe pajisje që mund të përbëjnë burim rreziku për zjarrin. Gjithashtu, punimet kryhen në një territor me karakter natyror, ku një incident zjarri mund të shkaktojë pasoja më të gjera përtej zonës së drejtpërdrejtë të kantierit.

Rreziku nga zjarri mund të lidhet veçanërisht me:

- a) përdorimin e makinerive dhe mjeteve me motor;
- b) përdorimin e karburanteve dhe lubrifikantëve;
- c) përdorimin e pajisjeve elektrike;
- d) punimet elektrike;
- e) punimet e montimit dhe ndërhyrjet teknike;
- f) punimet me materiale të ndryshme të djegshme;
- g) strukturat dhe elementët prej druri;
- h) punimet në terren me bimësi dhe materiale natyrore.

Eksperti zjarrfikës ka rol në ndjekjen e masave parandaluese, kontrollin e kushteve të sigurisë nga zjarri, orientimin e punonjësve dhe reagimin fillestar në rast të një situatë të tillë.

Prania e këtij specialisti është veçanërisht e rëndësishme për shkak të karakterit natyror të territorit ku zhvillohet objekti, ku një zjarr i pakontrolluar mund të përhapet me shpejtësi.

Tre profilet e kërkuara kanë funksione të ndryshme dhe nuk mbivendosen me njëri-tjetrin.

Specialisti për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë ka funksion kryesisht parandalues dhe organizativ, duke ndjekur rreziqet profesionale dhe masat e sigurisë gjatë proceseve të punës.

Eksperti për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave ka funksion të drejtpërdrejtë në reagimin fillestar ndaj dëmtimeve dhe emergjencave shëndetësore.

Eksperti zjarrfikës mbulon aspektin e parandalimit dhe reagimit ndaj rrezikut nga zjarri dhe situatave të shpëtimit.

Për këtë arsye, kërkesa për të tre profilet nuk përbën përsëritje të të njëjtit funksion, por krijon një strukturë minimale mbështetëse që mbulon tre kategori të ndryshme rreziku.

Kërkesa që personeli të jetë i pajisur, sipas rastit, me diplomë, dëshmi/certifikatë kualifikimi ose trajnimi, është vendosur për të siguruar që personat e deklaruar kanë kompetencat e nevojshme për funksionin që do të ushtrojnë. Në veçanti, për specialistin e sigurimit teknik dhe shëndetit në punë kërkohet dëshmi trajnimi e lëshuar nga organizma kompetentë, sipas kërkesave të përcaktuara në kriter. Për ekspertin e ndihmës së parë kërkohet certifikimi përkatës nga subjektet e përcaktuara në kriter, ndërsa për ekspertin zjarrfikës kërkohet dokumentacioni/certifikata përkatëse e lëshuar nga organi kompetent. Këto kërkesa sigurojnë që personeli mbështetës të ketë një kualifikim të verifikueshëm dhe të përshtatshëm për funksionin e deklaruar.

Kërkesa që personeli i mësipërm të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik për muajin Korrik 2026 është përcaktuar për të provuar disponimin real të personelit në periudhën e përcaktuar. Duke qenë se këta persona kanë funksione të rëndësishme mbështetëse në menaxhimin e sigurisë dhe emergjencave, është e nevojshme që operatori ekonomik të dëshmojë se i disponon realisht dhe nuk mbështetet vetëm në deklarin e tyre për qëllime kualifikimi.

Në këtë mënyrë, verifikohet lidhja faktike e operatorit ekonomik me personelin e deklaruar dhe kapaciteti i tij për të organizuar punimet duke pasur në dispozicion burimet njerëzore të kërkuara.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore për muajin Korrik 2026, prej jo më pak se 30 (tridhjetë) personash.

Numri minimal i fuqisë punëtore është përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën, shtrirjen dhe kompleksitetin e punimeve objekt kontrate, si dhe nevojën për realizimin paralel të proceseve të ndryshme të punës në kantier, duke përfshirë punimet e ndërtimit, punimet hidraulike dhe elektrike, punimet e betonit, hekurit, muraturës, karpenterisë, konstruksioneve metalike, punimet me makineri dhe mjetet e transportit, si dhe punimet ndihmëse dhe të sigurimit të kantierit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit disponimin e jo më pak se 30 (tridhjetë) punonjësve për muajin Korrik 2026.

Kriteri do të vërtetohet nëpërmjet:

- a) vërtetimit të lëshuar nga administrata tatimore, nga i cili evidentohet numri i punonjësve;*
- b) listëpagesave të punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës të deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.*

Disponimi i personelit të kërkuar do të deklarohet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Kriteri lidhet drejtpërdrejt me natyrën, volumet dhe organizimin e punimeve të parashikuara në specifikimet teknike. Ky numër përfaqëson minimumin e nevojshëm për të garantuar që punimet të zhvillohen paralelisht, me cilësi dhe në përputhje me kërkesat për siguri, mjedis dhe afate. Një numër më i ulët do të detyronte operatorin të kryente proceset në mënyrë të fragmentuar, duke rritur rrezikun e vonesave, uljes së cilësisë dhe mosrespektimit të kushteve teknike të kontratës.

Kjo kërkesë nuk është përcaktuar vetëm mbi bazën e volumit të përgjithshëm të punimeve, por në funksion të organizimit real të kantierit dhe nevojës për të pasur në dispozicion një numër të mjaftueshëm punonjësish për zhvillimin e proceseve të ndryshme të punës, të cilat sipas fazave të zbatimit duhet të realizohen në mënyrë të njëpasnjëshme dhe, në raste të caktuara, paralelisht.

Preventivi i objektit përfshin një gamë të gjerë punimesh, ndër të cilat: punime shpyllëzimi; punime gjermimi; punime dheu; punime shtresash; punime betoni dhe betonarme; punime murature guri; punime hidroizolimi dhe çatie; instalime hidro-sanitare dhe ngrohje; ndërtim veprash arti dhe kanalizime; struktura druri; konstruksione dhe montime; sinjalistikë dhe tabela informuese; pastrime dhe dezinfektim; pastrim nga gurët; sistemim dhe sheshim të shtegut; si dhe punime mirëmbajtjeje.

Kjo shumëllojshmëri e proceseve kërkon organizimin e disa ekipeve të punës me profesione dhe funksione të ndryshme. Për më tepër, duke qenë se objekti realizohet në një shteg dhe në terren me karakter natyror, proceset e punës duhet të përshtaten me kushtet e terrenit dhe me rendin teknologjik të përcaktuar në projekt.

Numri minimal prej 30 (tridhjetë) personash është përcaktuar duke analizuar nevojën për të organizuar fuqinë punëtore në disa grupe funksionale, të cilat duhet të mbulojnë njëkohësisht ose në faza të ndryshme proceset kryesore të zbatimit.

Në këtë drejtim, struktura minimale e fuqisë punëtore mund të argumentohet si më poshtë:

Grupi i punës	Numri minimal	Funksioni kryesor
Personel teknik dhe drejtues i zbatimit	2	Organizimi dhe ndjekja e proceseve të punës në terren
Betonues	2	Punimet e betonit dhe elementëve betonarme
Hekurthyesh	2	Përgatitja dhe montimi i armaturës
Karpentierë	2	Kallëpime, struktura dhe elementë druri
Muratorë/suvatues	2	Muraturë guri dhe punime përkatëse
Punonjës për konstruksione	2	Montimi dhe fiksimi i elementëve konstruktivë

metalike/montim

Punonjës për punime në lartësi	2	Çati, struktura dhe punime në kuota të ngritura
Drejtues mjetesh/makinerish të rënda	2	Gërmime, sistemim dhe punime mekanike të terrenit
Shoferë	2	Transport materialesh, pajisjesh dhe mbetjesh
Hidraulik	1	Instalime hidro-sanitare dhe ngrohje
Elektricitist	1	Punime dhe instalime elektrike
Punonjës të përgjithshëm/ndihmës	5	Shërbime ndihmëse, transport manual, pastrim, sistemim dhe mbështetje e ekipave
Personel mbështetës për sigurinë dhe emergjencat	3	Siguria teknike, ndihma e parë dhe mbrojtja nga zjarri
TOTAL	30	

Kjo strukturë nuk nënkupton se të gjithë punonjësit do të jenë të angazhuar çdo ditë në të njëjtin proces pune. Përkundrazi, ajo pasqyron fuqinë minimale që duhet të jetë në dispozicion të operatorit ekonomik, në mënyrë që gjatë fazave të ndryshme të zbatimit të mund të organizohen ekiye pune sipas nevojave të kantierit.

Një nga grupet kryesore të punimeve të preventivit përbëhet nga punimet e gërmimit, punimet e dheut, pastrimi nga gurët dhe sistemimi/sheshimi i shtegut. Këto punime kërkojnë ndërhyrje të drejtpërdrejtë në terren dhe përdorimin e mjeteve dhe makinerive të përshtatshme. Për realizimin e tyre nevojiten drejtues të kualifikuar të makinerive të rënda, si dhe punonjës ndihmës për orientimin e punimeve, sistemimin manual të zonave ku makineritë nuk mund të ndërhyjnë dhe përpunimin përfundimtar të sipërfaqeve. Në këtë proces, 2 drejtues makinerish/mjetesh të rënda mundësojnë përdorimin e njëkohshëm ose të alternuar të mjeteve të ndryshme, ndërsa punonjësit ndihmës kryejnë proceset manuale të shoqëruara me punimet mekanike. Kjo është e rëndësishme pasi shtegu zhvillohet në terren natyror dhe jo në një sipërfaqe të rrafshët e të standardizuar, duke kërkuar kombinimin e punimeve mekanike me ato manuale.

Punimet e shtresave kërkojnë përgatitjen e bazamentit, shpërndarjen dhe sistemimin e materialeve, nivelimin dhe përpunimin e tyre. Këto procese duhet të koordinohen me punimet e gërmimit dhe të sistemimit të terrenit dhe me kontrollin topografik të kuotave dhe pjerrësive. Për këtë arsye, fuqia punëtore nuk mund të kufizohet vetëm në operatorët e makinerive, por kërkohet edhe prania e punonjësve ndihmës dhe e personelit teknik që ndjek procesin.

Preventivi përmban punime betoni dhe betonarmeje, si dhe punime që lidhen me veprat e artit dhe kanalizimet. Realizimi i këtyre proceseve kërkon bashkërendimin e të paktën tre profesioneve kryesore:

- betonuesve, të cilët kryejnë procesin e vendosjes dhe përpunimit të betonit;
- hekurthyesve, të cilët përgatisin dhe montojnë armaturën;
- karpentierëve, të cilët përgatisin dhe montojnë kallëpet.

Për këtë arsye janë parashikuar 2 betonues + 2 hekurthyes + 2 karpentierë, duke krijuar një ekip minimal prej 6 punonjësish për proceset e betonarmesë.

Ky organizim është i nevojshëm pasi këto procese janë të lidhura teknologjikisht me njëri-tjetrin dhe duhet të realizohen sipas një radhe të përcaktuar. Në veçanti, përgatitja e armaturës, kallëpimi

dhe betonimi nuk mund të trajtohen si procese të izoluara, pasi përfundimi i njërit kushtëzon fillimin e procesit pasardhës.

Preventivi përmban punime murature guri, të cilat kërkojnë punonjës me aftësi praktike specifike. Për këtë proces janë parashikuar 2 muratorë/suvatues, të cilët mund të organizohen si një ekip pune për realizimin e mureve, përpunimin e lidhjeve, vendosjen e gurëve dhe përfundimin e sipërfaqeve sipas specifikimeve teknike. Kërkesa për dy persona mundëson realizimin e punimeve në mënyrë të vazhdueshme dhe lejon ndarjen e proceseve të përgatitjes, vendosjes dhe përpunimit.

Preventivi përfshin struktura druri, si dhe procese që kërkojnë përdorimin e kallëpeve në punimet e betonit dhe betonarmesë. Për këtë arsye janë parashikuar 2 karpentierë, të cilët mund të angazhohen si në realizimin e strukturave prej druri, ashtu edhe në proceset e kallëpimit të elementeve prej betoni, në varësi të fazës së zbatimit. Kjo siguron që procesi i kallëpimit të mos krijojë vonesa në punimet e betonit dhe që strukturat prej druri të realizohen nga personel me aftësi të përshtatshme.

Për realizimin e konstruksioneve metalike dhe proceseve të montimit, është parashikuar një ekip prej 2 punonjësish. Këta punonjës janë të nevojshëm për manipulimin, pozicionimin, montimin dhe fiksimin e elementeve konstruktive. Dy persona përbëjnë një ekip minimal funksional për procese që kërkojnë shpesh manipulim manual dhe koordinim të drejtpërdrejtë gjatë montimit.

Objekti përfshin punime çatie, struktura dhe elemente që mund të realizohen në kuota të ngritura, për të cilat nevojitet personel i kualifikuar për punime në lartësi. Për këtë arsye janë parashikuar 2 punonjës të kualifikuar për punime në lartësi. Numri dy është i nevojshëm për të krijuar një ekip pune që mund të kryejë ndërhyrje në lartësi duke respektuar masat e sigurisë dhe duke mundësuar mbështetjen reciproke gjatë realizimit të punimeve.

Në preventiv janë parashikuar instalime hidro-sanitare dhe ngrohje, për të cilat kërkohet një punonjës hidraulik. Për këtë proces është parashikuar 1 hidraulik, pasi bëhet fjalë për një proces të specializuar dhe me shtrirje më të kufizuar në raport me punimet e përgjithshme.

Në të njëjtën mënyrë, për komponentët elektrikë është parashikuar 1 elektrikist, i cili mbulon proceset elektrike të parashikuara në projekt. Kërkesa për nga një specialist për secilin prej këtyre profileve është proporcionale me karakterin specifik dhe volumn relativ të këtyre proceseve.

Punimet e gërmimit, pastrimit, sistemimit dhe ndërtimit gjenerojnë nevojë të vazhdueshme për lëvizjen e materialeve, mbetjeve dhe pajisjeve.

Për këtë arsye janë parashikuar:

- 2 drejtues të mjeteve/makinerive të rënda, për proceset mekanike të gërmimit, sistemimit dhe manipulimit të materialeve;
- 2 shoferë, për transportin e materialeve, pajisjeve, mbetjeve dhe nevojave të tjera logjistike të kantierit.

Disponimi i këtij personeli krijon mundësinë që proceset e transportit dhe të punimeve mekanike të mos varen nga një person i vetëm dhe të mund të zhvillohen sipas organizimit të kantierit.

Në përbërjen e fuqisë minimale prej 30 personash janë parashikuar edhe 5 punonjës të përgjithshëm/ndihmës. Këta punonjës janë të nevojshëm për proceset që nuk kërkojnë një profesion të posaçëm, por që janë të domosdoshme për realizimin e punimeve, si:

- transporti dhe manipulimi manual i materialeve;
- ngarkimi dhe shkarkimi i materialeve;
- pastrimi i zonave të punës;
- largimi i mbetjeve dhe materialeve të papërshtatshme;

- pastrimi nga gurët;
- sistemimi manual i shtegut;
- mbështetja e ekipeve të betonimit, muraturës, karpenterisë dhe montimit;
- përgatitja e zonave të punës;
- punime të ndryshme ndihmëse që dalin gjatë procesit të zbatimit.

Këta punonjës janë veçanërisht të nevojshëm për shkak të karakterit të terrenit dhe faktit që një pjesë e punimeve nuk mund të realizohet vetëm me mjete mekanike.

Në fuqinë e përgjithshme minimale prej 30 personash përfshihet edhe personeli mbështetës i parashikuar në kriterin 2.3.4, konkretisht:

- 1 specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë;
- 1 ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave;
- 1 ekspert zjarrfikës.

Këta persona kanë funksion mbështetës dhe janë të nevojshëm për shkak të natyrës së punimeve dhe rrezeve që shoqërojnë përdorimin e makinerive, gërmimet, punimet në lartësi, punimet e betonit, montimet dhe punimet në terren natyror.

Numri 30 (tridhjetë) është përcaktuar duke marrë në konsideratë nevojën për të organizuar në mënyrë funksionale disa ekipe pune, pa nënkuptuar që të gjithë punonjësit do të jenë të angazhuar në të njëjtën kohë në të njëjtin proces. Në një fazë të zbatimit mund të jenë aktive punimet e gërmimit dhe sistemimit të terrenit, ndërsa në një fazë tjetër mund të zhvillohen paralelisht punimet e betonit, armaturës, karpenterisë dhe muraturës. Në mënyrë të ngjashme, instalimet hidro-sanitare, punimet elektrike, strukturat, montimet dhe punimet në lartësi mund të zhvillohen në faza të ndryshme ose në segmente të ndryshme të objektit.

Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të ketë një bazë të mjaftueshme të fuqisë punëtore në mënyrë që ndryshimi i fazave të punimeve të mos shkaktojë ndërprerje ose vonesa në zbatimin e kontratës.

Përcaktimi i numrit 30 është rezultat i nevojës për të mbuluar njëkohësisht punimet e terrenit dhe gërmimet, punimet e shtresave, punimet e betonit, punimet e betonarmesë, punimet e armaturës; punimet e karpenterisë, punimet e muraturës së gurit, punimet e konstruksioneve dhe montimit; punimet në lartësi, punimet hidro-sanitare, punimet elektrike, transportin dhe përdorimin e makinerive, pastrimin dhe sistemimin, punimet ndihmëse, sigurinë teknike dhe emergjencat.

Kërkesa për 30 persona nuk duhet të kuptohet si kërkesë që të gjithë këta punonjës të jenë të angazhuar në mënyrë të pandërprerë në të gjitha ditët dhe në të gjitha proceset. Ajo përcakton kapacitetin minimal të fuqisë punëtore që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, duke i dhënë mundësi të organizojë burimet njerëzore sipas grafikut të punimeve dhe sipas fazave konkrete të zbatimit. Kjo është e nevojshme veçanërisht për një objekt me karakter linear dhe me procese të shpërndara në terren, ku ekipet mund të duhet të zhvendosen në segmente të ndryshme të shtegut. Kërkesa për këtë fuqi punëtore përfaqëson një kërkesë minimale për të garantuar që operatori ekonomik të ketë kapacitetin real njerëzor për të organizuar, koordinuar dhe përfunduar punimet brenda afateve të përcaktuara dhe sipas kërkesave të projektit, preventivit dhe specifikimeve teknike.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet, makineritë dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Nr. Mjeti/Makineria/Pajisja</i>	<i>Disponimi</i>	<i>Sasia</i>
1 Minieskavator me zinxhir gome	Pronësi ose me qira	2 copë
2 Kamion me vinç	Pronësi ose me qira	1 copë
3 Kamion vetëshkarkues	Pronësi ose me qira	1 copë
4 Kamionçinë 2.5–7.5 ton	Pronësi ose me qira	1 copë
5 Eskavator me zinxhir	Pronësi ose me qira	1 copë
6 Minifadromë	Pronësi ose me qira	1 copë
7 Kontenier	Pronësi ose me qira	1 copë
8 Gjenerator kantieri	Pronësi ose me qira	1 copë
9 Betoniere kantieri	Pronësi ose me qira	2 copë
10 Vibrues	Pronësi ose me qira	2 copë
11 Vibrator ngjeshës pllakash	Pronësi ose me qira	1 copë
12 Matrapik	Pronësi ose me qira	2 copë
13 Karroca dore	Pronësi ose me qira	5 copë
14 Kazma	Pronësi ose me qira	5 copë
15 Nivelues betoni	Pronësi ose me qira	1 copë
16 GPS Base and Rover	Pronësi ose me qira	1 set
17 Autobot uji	Pronësi ose me qira	1 copë
18 Asfaltopërhapëse	Pronësi ose me qira	1 copë
19 Autobetoniere	Pronësi ose me qira	2 copë
20 Kamion pompë betoni	Pronësi ose me qira	1 copë

Në zbatim të kërkesave për sigurinë dhe shëndetin në punë, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë gjithashtu pajisjet e mëposhtme të mbrojtjes individuale dhe pajisjet e sigurisë në kantier:

- 30 (tridhjetë) kokore mbrojtëse;*
- 30 (tridhjetë) jelekë fosforeshentë për kantier;*
- 4 (katër) komplete të ndihmës së shpejtë;*
- 4 (katër) fikëse zjarri të lëvizshme.*

Dokumentacioni provues për mjetet dhe makineritë

Për mjetet në pronësi duhet të paraqiten:

- a) dokumenti që vërteton pronësinë e mjetit;*
- b) leja e qarkullimit, kur mjeti është i regjistruar për qarkullim;*
- c) certifikata e kontrollit teknik, kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi;*
- ç) dokumenti i sigurimit të detyrueshëm të mjetit, i vlefshëm.*

Për mjetet e deklaruar me qira duhet të paraqiten:

- a) kontrata e qirasë, e vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës;*
- b) dokumenti që vërteton pronësinë e mjetit nga qiradhënësi;*
- c) leja e qarkullimit, kur mjeti është i regjistruar për qarkullim;*
- ç) certifikata e kontrollit teknik, kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi;*
- d) dokumenti i sigurimit të detyrueshëm të mjetit, i vlefshëm.*

Për mjetet që transportojnë mallra të klasifikuara si të rrezikshme sipas legjislacionit në fuqi, duhet të paraqitet edhe certifikata/autorizimi përkatës për transportin e mallrave të rrezikshme, e lëshuar nga institucionet kompetente dhe e vlefshme.

Dokumentacioni provues për pajisjet teknike

Për pajisjet teknike në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë, si kontratë shitblerjeje, faturë tatimore ose dokument tjetër i barasvlershëm, së bashku me dokumentin që përmban të dhënat teknike të pajisjes.

Kur pajisjet teknike janë marrë me qira, duhet të paraqiten:

- *kontrata e qirasë;*
- *dokumenti që provon pronësinë e pajisjes nga qiradhënësi;*
- *dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.*

Për mjetet dhe pajisjet teknike të deklaruar, operatori ekonomik duhet të paraqesë fotografi të qarta dhe të identifikueshme për secilin mjet dhe pajisje. Për mjetet e targuara, në fotografi duhet të jetë e dukshme njëkohësisht mjeti dhe targa e tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- *deklaratë për pranimin e verifikimit fizik të mjeteve dhe pajisjeve nga Autoriteti Kontraktor, në çdo kohë gjatë periudhës së realizimit të kontratës;*
- *deklaratë se mjetet dhe pajisjet e deklaruar janë në dispozicion për realizimin e kontratës dhe nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera në mënyrë që pengon përdorimin e tyre për këtë kontratë;*
- *deklaratë mbi vendndodhjen e mjeteve dhe pajisjeve, me qëllim mundësimin e verifikimit nga Autoriteti Kontraktor.*

Disponimi i mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të kërkuara do të deklarohet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

Nëpërmjet kësaj kërkese, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qëllim permbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Lloji dhe numri i mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës është përcaktuar duke u bazuar në zerrat e preventivit dhe specifikimeve teknike. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Përcaktimi i paisjeve dhe makinerive është bërë duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit, mundësive të manovrimit me mjete të rënda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj.

Kërkesa për 2 minieskavatorë me zinxhir gome lidhet me nevojën për realizimin e punimeve të gërmimit, pastrimit, sistemimit të terrenit dhe ndërhyrjeve në zona ku përdorimi i një eskavatori të madh është i vështirë ose i pamundur. Duke qenë se objekti zhvillohet në një shteg dhe në terren natyror, prania e zonave të ngushta dhe aksesit të kufizuar kërkon mjete me përmasa të vogla dhe manovrueshmëri të lartë. Dy njësi janë kërkuar për të mundësuar ndërhyrje në segmente të ndryshme të shtegut dhe për të shmangur varësinë nga një makineri e vetme gjatë fazave të punimeve.

Kamioni me vinç është i nevojshëm për ngarkimin, transportin dhe shkarkimin e materialeve dhe elementeve konstruktive, veçanërisht për materialet që nuk mund të manipulohen lehtësisht me mjete të zakonshme. Ai mund të përdoret për transportin dhe vendosjen e elementeve të strukturave, materialeve për veprat e artit, elementeve prej druri, konstruksioneve dhe pajisjeve të tjera. Kërkesa për një njësi është e mjaftueshme për mbulimin e nevojave logjistike të objektit.

Kamioni vetëshkarkues është i nevojshëm për transportin dhe shkarkimin e materialeve të gërmuara, materialeve të shtresave, inerteve dhe mbetjeve të krijuara gjatë punimeve. Ky mjet lidhet drejtpërdrejt me punimet e gërmimit, punimet e dheut, sistemimin e terrenit, ndërtimin e shtresave dhe pastrimin e zonave të punës. Kërkesa për një kamion vetëshkarkues siguron një kapacitet minimal të transportit dhe largimit të materialeve.

Kamionçina është e nevojshme për transportin e materialeve, veglave, pajisjeve të vogla dhe elementeve të ndryshme që nevojiten gjatë zbatimit të punimeve. Ajo plotëson mjetet e transportit të rëndë dhe është veçanërisht e përshtatshme për lëvizje në segmente të ndryshme të objektit ku nuk është e nevojshme përdorimi i kamionëve të mëdhenj.

Eskavatori me zinxhir është i nevojshëm për punimet kryesore të gërmimit dhe sistemimit të terrenit, përfshirë hapjen e kanaleve, gërmimet për themele, veprat e artit dhe kanalizimet. Për shkak të karakterit të terrenit, eskavatori me zinxhir ofron stabilitet dhe kapacitet të përshtatshëm për punime në terrene të pabarabarta dhe me pjerrësi. Kërkesa për një njësi lidhet me nevojën për të pasur një mjet kryesor mekanik për punimet e gërmimit.

Minifadromë është e nevojshme për ngarkimin, zhvendosjen dhe sistemimin e materialeve dhe inerteve, veçanërisht në zonat ku nevojitet manovrim më i shpejtë dhe më fleksibël. Ajo plotëson funksionin e eskavatorëve dhe kamionëve dhe mund të përdoret për sistemimin e materialeve në kantier dhe në segmentet e shtegut.

Kontenieri është i nevojshëm për organizimin e kantierit, ruajtjen e materialeve, veglave dhe pajisjeve, si dhe për mbajtjen e materialeve të mbrojtura nga kushtet atmosferike. Duke qenë se

objekti zhvillohet në terren natyror dhe në zona të ndryshme të shtegut, është e nevojshme të sigurohet një hapësirë e përshtatshme për ruajtjen e mjeteve dhe materialeve të punës.

Gjeneratori është i nevojshëm për sigurimin e energjisë elektrike në kantier, veçanërisht në zonat ku nuk ekziston një furnizim i qëndrueshëm me energji. Ai mundëson përdorimin e pajisjeve elektrike, mjeteve të punës dhe ndriçimit të nevojshëm gjatë realizimit të proceseve. Kërkesa për një gjenerator është e përshtatshme me nevojën për një burim alternativ energjie në kantier.

Kërkesa për 2 betoniere kantieri lidhet me volumin dhe shpërndarjen e punimeve të betonit dhe betonarmesë, veprave të artit, kanalizimeve dhe elementeve të tjera prej betoni. Dy betoniere mundësojnë prodhimin dhe përgatitjen e betonit në më shumë se një pikë pune ose në segmente të ndryshme të objektit, duke reduktuar kohën e pritjes dhe duke lehtësuar organizimin paralel të proceseve. Numri dy lidhet veçanërisht me karakterin linear të shtegut, ku punimet nuk zhvillohen domosdoshmërisht në një pikë të vetme.

Vibruesit janë pajisje të domosdoshme për ngjeshjen dhe konsolidimin e betonit gjatë realizimit të elementeve betonarme. Kërkesa për 2 vibrues lidhet me nevojën për të garantuar vazhdimësinë e procesit të betonimit dhe mundësinë e përdorimit të pajisjeve në pika të ndryshme pune. Disponimi i dy njësive krijon edhe një rezervë funksionale në rast të ndërprerjes së njërës pajisje.

Vibratori ngjeshës i pllakave është i nevojshëm për ngjeshjen e shtresave të tokës, materialeve granulare dhe sipërfaqeve të sistemuara, duke siguruar dendësinë dhe stabilitetin e kërkuar. Ai lidhet drejtpërdrejt me punimet e shtresave dhe sistemimin/sheshimin e shtegut.

Matrapikët janë të nevojshëm për thyerjen, çarjen dhe heqjen e materialeve të forta, përfshirë gurët, betonin ekzistues ose materiale të tjera që mund të hasen gjatë gërmimit dhe sistemimit të shtegut. Dy copë janë kërkuar për të mundësuar punë të njëkohshme nga dy punonjës ose ndërhyrje në segmente të ndryshme.

Karrocat e dorës janë veçanërisht të rëndësishme për këtë objekt për shkak të karakterit të tij linear dhe terrenit natyror. Ato përdoren për transportin manual të gurëve, materialeve, inerteve, betonit, mbetjeve dhe materialeve të tjera, në zonat ku mjetet e mekanizuara nuk mund të hyjnë.

Kërkesa për 5 karroca dore është lidhur me nevojën për të mbështetur njëkohësisht disa ekipe pune. Kazmat janë mjete të domosdoshme për punimet manuale të gërmimit, pastrimit, sistemimit dhe përpunimit të terrenit. Në një objekt që zhvillohet në terren natyror, punimet mekanike duhet të shoqërohen me punime manuale, veçanërisht në zona të ngushta, pranë strukturave ekzistuese ose në vende ku makineritë nuk mund të ndërhyjnë. Kërkesa për 5 kazma lidhet me mundësinë e angazhimit paralel të disa punonjësve në procese të ndryshme.

Niveluesi i betonit është i nevojshëm për nivelimin dhe përfundimin e sipërfaqeve të betonit, duke garantuar respektimin e kuotave dhe parametrave teknikë të parashikuar. Pajisja lidhet drejtpërdrejt me punimet e betonit dhe betonarmesë.

Disponimi i një seti GPS Base and Rover është i nevojshëm për realizimin e punimeve të rilevimit, piketimit, kontrollit të kuotave dhe pozicionimit të elementeve të projektit. Për shkak të karakterit linear të shtegut dhe ndryshimit të kuotave të terrenit, kontrolli topografik është veçanërisht i rëndësishëm për pozicionimin e aksit të shtegut, kontrollin e kuotave, kontrollin e pjerrësive, piketimin e veprave të artit, kanalizimet, shtresat, elementet konstruktive dhe strukturat. Për këtë arsye, një set GPS Base and Rover përbën një pajisje të nevojshme për saktësinë e zbatimit.

Autoboti i ujit është i nevojshëm për furnizimin me ujë dhe lagështimin e materialeve dhe sipërfaqeve gjatë punimeve, si dhe për kontrollin e pluhurit në zonat e punës. Ai mund të përdoret gjatë punimeve të shtresave, sistemimit të shtegut, ngjeshjes së materialeve dhe pastrimit të

sipërfaqeve. Në një objekt të zhvilluar në terren natyror, ku mund të mungojë furnizimi i drejtpërdrejtë me ujë, disponimi i këtij mjeti është i nevojshëm për organizimin e pavarur të kantierit.

Kërkesa për asfaltopërhapëse lidhet me punimet e shtresave dhe përhapjen e materialeve të parashikuara për sipërfaqet përkatëse, sipas projektit dhe preventivit. Disponimi i saj siguron që operatori ekonomik të ketë kapacitetin mekanik për realizimin e shtresave në mënyrë të kontrolluar dhe uniforme, në rastet kur teknologjia e punimit kërkon përdorimin e saj.

Kërkesa për 2 autobetoniere lidhet me transportin dhe furnizimin e kantierit me beton të gatshëm, veçanërisht gjatë fazave të betonimit të veprave të artit, elementeve betonarme dhe strukturave të ndryshme. Dy autobetoniere mundësojnë furnizim më të vazhdueshëm me beton dhe reduktojnë rrezikun e ndërprerjes së procesit të betonimit për shkak të pritjes së transportit. Kjo është e rëndësishme pasi betonimi është një proces teknologjik që kërkon vazhdimësi.

Kamioni pompë betoni është i nevojshëm për vendosjen e betonit në elemente dhe zona ku transporti manual ose me mjete të zakonshme është i vështirë. Ai është veçanërisht i rëndësishëm për elementet betonarme, veprat e artit dhe strukturat ku kërkohet furnizim i kontrolluar me beton. Disponimi i një pompe betoni siguron kapacitetin e nevojshëm për realizimin e proceseve të betonimit me efikasitet dhe siguri.

Përveç mjeteve dhe makinerive, kërkesa për:

- 30 kokore mbrojtëse;
- 30 jelekë fosforeshentë;
- 4 komplete të ndihmës së shpejtë;
- 4 fikëse zjarri të lëvizshme,

është përcaktuar në funksion të numrit minimal të fuqisë punëtore dhe rreziqeve të veçanta të objektit.

30 kokore mbrojtëse dhe 30 jelekë fosforeshentë. Numri 30 për këto pajisje është i lidhur drejtpërdrejt me kriterin 2.3.5, i cili kërkon disponimin e jo më pak se 30 punonjësve. Çdo punonjës që angazhohet në zonën e kantierit duhet të ketë pajisjet bazë individuale të mbrojtjes dhe identifikimit. Jelekët fosforeshentë janë veçanërisht të rëndësishëm për një objekt ku përdoren eskavatorë, minieskavatorë, kamionë, minifadromë dhe mjete të tjera, pasi rrisin dukshmërinë e punonjësve ndaj operatorëve të makinerive.

Kërkesa për 4 komplete lidhet me shtrirjen e objektit dhe nevojën për të pasur pajisje të ndihmës së parë në më shumë se një pikë të punës. Duke qenë se shtegu ka karakter linear dhe ekipet mund të jenë të shpërndara në segmente të ndryshme, një komplet i vetëm mund të mos sigurojë akses të menjëhershëm në çdo zonë.

Katër fikëse zjarri janë përcaktuar për mbulimin e pikave kryesore të rrezikut në kantier, veçanërisht në afërsi të makinerive, gjeneratorit, mjeteve të transportit, zonave të punës dhe ruajtjes së materialeve. Kjo kërkesë lidhet me përdorimin e makinerive me motor, karburanteve, pajisjeve elektrike dhe gjeneratorit të kantierit, si dhe me karakterin natyror të zonës ku zhvillohen punimet.

Përcaktimi që mjetet, makineritë dhe pajisjet të mund të disponohen në pronësi ose me qira është bërë me qëllim që kërkesa të jetë proporcionale dhe të mos kufizojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë. Autoriteti Kontraktor nuk kërkon që operatori ekonomik të jetë domosdoshmërisht pronar i të gjitha mjeteve, por vetëm që të provojë se i ka ato realisht në dispozicion për periudhën

e realizimit të kontratës. Kjo i lejon operatorëve ekonomikë që nuk kanë në pronësi të gjitha pajisjet e nevojshme t'i sigurojnë ato nëpërmjet marrëdhënieve të ligjshme të qirasë.

Kërkesa për dokumentacionin e pronësisë ose qirasë, dokumentet e regjistrimit, kontrollit teknik dhe sigurimit, sipas rastit, është përcaktuar për të garantuar që mjetet e deklaruar janë reale, të identifikueshme, funksionale dhe të ligjshme për përdorim. Kërkesa për fotografi të mjeteve dhe pajisjeve synon të mundësojë identifikimin konkret të tyre dhe të shmangë deklarin e mjeteve që nuk ekzistojnë ose që nuk janë në dispozicion të operatorit ekonomik. Për mjetet e treguara, kërkesa që në fotografi të jetë e dukshme njëkohësisht mjeti dhe targa mundëson lidhjen e drejtpërdrejtë të fotografisë me dokumentacionin e paraqitur.

Kërkesa që operatori ekonomik të deklarojë pranimin e verifikimit fizik të mjeteve dhe pajisjeve nga Autoriteti Kontraktor është përcaktuar për të garantuar mundësinë e kontrollit të disponimit real të kapaciteteve të deklaruar. Gjithashtu, deklarimi se mjetet dhe pajisjet nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera në mënyrë që pengon përdorimin e tyre për këtë kontratë lidhet drejtpërdrejt me nevojën që kapacitetet e deklaruar të jenë realisht të disponueshme gjatë zbatimit. Kërkesa për deklarin e vendndodhjes së mjeteve dhe pajisjeve krijon mundësinë e verifikimit të tyre nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme, të vlefshme në datën e paraqitjes së ofertës:

- ISO 9001 – për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, ose ekuivalent;
- ISO 14001 – për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor, ose ekuivalent;
- ISO 45001 – për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, ose ekuivalent;
- PAS 99:2012 – për Sistemin e Menaxhimit të Integruar, ose ekuivalent.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga organe certifikuese të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kërkesat për certifikatat do të përmbushen në përputhje me pjesën e punimeve që secili anëtar i bashkimit merr përsipër të realizojë, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik do të vetëdeklarojë disponimin e certifikatave në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe, kur kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor, do të paraqesë kopjet e certifikatave përkatëse.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale”

“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”, nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga

organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidh, janë kërkuar këto certifikata me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit”.

Kërkesa për certifikimin sipas ISO 9001 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë, ose ekuivalent, lidhet drejtpërdrejt me nevojën për të garantuar që punimet objekt kontrate të realizohen në përputhje me projektin, specifikimet teknike, preventivin, standardet teknike dhe kërkesat e cilësisë të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Objekti përfshin një numër të konsiderueshëm procesesh teknike, ndër të cilat punime gërmimi dheu, punime shtresash, punime betoni dhe betonarmeje, punime armature dhe kallëpimi, muraturë guri, vepra arti, kanalizime, instalime hidro-sanitare, struktura druri, punime hidroizolimi dhe çatie, punime montimi dhe sistemim dhe sheshim të shtegut.

Secili prej këtyre proceseve ka kërkesa specifike teknike dhe duhet të kontrollohet në faza të ndryshme të zbatimit. Në këtë kuadër, një sistem menaxhimi të cilësisë sipas ISO 9001 siguron një qasje të strukturuar për planifikimin, zbatimin, kontrollin dhe përmirësimin e proceseve, si dhe për evidentimin dhe trajtimin e mospërputhjeve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për punimet e betonit dhe betonarmesë, ku cilësia e materialeve, përgatitja dhe vendosja e armaturës, kallëpimi, betonimi, vibrimi dhe përfundimi duhet të realizohen sipas kërkesave teknike. Në të njëjtën mënyrë, për punimet e shtresave dhe sistemimit të shtegut, kontrolli i materialeve, trashësisë së shtresave, kuotave, pjerrësive dhe ngjeshjes kërkon një proces të dokumentuar kontrolli të cilësisë. Për këtë arsye, kërkesa për ISO 9001 synon të garantojë që operatori ekonomik të ketë një sistem të organizuar dhe të dokumentuar për menaxhimin e cilësisë së punimeve.

Kërkesa për ISO 14001 – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor, ose ekuivalent, justifikohet nga karakteri i veçantë i objektit, i cili realizohet në terren natyror dhe përfshin ndërhyrje të drejtpërdrejta në mjedis. Preventivi parashikon, ndër të tjera punime shpyllëzimi, gërmime dhe punime dheu, pastrim nga gurët, transport dhe largim materialesh, sistemim të terrenit, punime kanalizimesh, pastrime dhe dezinfektim si dhe procese të tjera që mund të gjenerojnë mbetje dhe ndikime të përkohshme në mjedis. Gjatë zbatimit të punimeve mund të krijohen materiale të gërmuara, mbetje ndërtimore, mbetje nga pastrimi i terrenit, pluhur dhe zhurma nga përdorimi i makinerive. Për më tepër, përdorimi i eskavatorëve, minieskavatorëve, kamionëve, gjeneratorit, autobetonierave dhe mjeteve të tjera të mekanizuara kërkon administrimin e aspekteve mjedisore që lidhen me përdorimin e karburanteve, lubrifikantëve, emetimeve, zhurmave dhe parandalimin e ndotjeve aksidentale. ISO 14001 siguron një kuadër të strukturuar për identifikimin dhe administrimin e aspekteve mjedisore, kontrollin e ndikimeve dhe zbatimin e masave për parandalimin dhe minimizimin e ndotjes. Kjo kërkesë është veçanërisht e përshtatshme për këtë objekt për shkak të ndërhyrjes në një territor me karakter natyror dhe peizazh të ndjeshëm, ku proceset e ndërtimit duhet të zhvillohen duke minimizuar ndikimin në mjedisin përreth.

Kërkesa për ISO 45001 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, ose ekuivalent, lidhet me natyrën e punimeve dhe nivelin e rrezikut që shoqëron realizimin e tyre. Në kantier do të përdoren eskavatorë, minieskavatorë, minifadromë, kamionë, autobetoniere, kamion pompë betoni, gjenerator, pajisje vibrimi dhe ngjeshjeje, matrapikë dhe mjete dhe pajisje të tjera mekanike. Gjithashtu, punimet përfshijnë gërmime, punime betonarmeje, punime në lartësi, montime, struktura, punime çatie dhe ndërhyrje në terren me pjerrësi, të cilat paraqesin rreziqe specifike për sigurinë e punonjësve. Për këtë arsye është e nevojshme që operatori ekonomik të

ketë një sistem të strukturuar për identifikimin e rreziqeve, vlerësimin dhe kontrollin e tyre, përcaktimin e masave parandaluese, trajnimin dhe ndërgjegjësimin e punonjësve, përdorimin e pajisjeve të mbrojtjes individuale dhe menaxhimin e incidenteve dhe emergjencave. Kërkesa për ISO 45001 lidhet gjithashtu me kërkesat e tjera të dokumenteve të tenderit për disponimin e personelit të kualifikuar për sigurinë dhe shëndetin në punë, ndihmën e parë dhe mbrojtjen nga zjarri, si dhe me kërkesën për pajisje të mbrojtjes individuale dhe pajisje sigurie në kantier. Në këtë mënyrë krijohet një sistem i integruar ku kërkesat për sigurinë nuk trajtohen vetëm në mënyrë formale, por si pjesë e organizimit të përgjithshëm të zbatimit të kontratës.

Kërkesa për PAS 99:2012 – Sistemi i Menaxhimit të Integruar, ose ekuivalent, është përcaktuar duke marrë në konsideratë faktin se objekti kërkon zbatimin e njëkohshëm të kërkesave që lidhen me cilësinë, mjedisin dhe sigurinë/shëndetin në punë. Në realizimin e kësaj kontrate, këto fusha nuk janë të ndara nga njëra-tjetra.

Për shembull, realizimi i një punimi betoni duhet të përmbushë njëkohësisht:

- kërkesat teknike dhe të cilësisë;
- kërkesat për menaxhimin e mbetjeve dhe ndikimit mjedisor;
- kërkesat për sigurinë e punonjësve gjatë procesit të betonimit.

Në mënyrë të ngjashme, punimet e gërmimit duhet të realizohen duke respektuar njëkohësisht kërkesat për saktësinë teknike, stabilitetin dhe sigurinë e punimeve, si dhe masat për mbrojtjen e mjedisit. PAS 99:2012 synon pikërisht integrimin e sistemeve të ndryshme të menaxhimit, duke shmangur trajtimin e tyre si procese të shkëputura dhe duke krijuar një kuadër të përbashkët menaxhimi. Kjo është e përshtatshme për objektin konkret për shkak të numrit të madh të proceseve, personelit, mjeteve dhe faktorëve që duhet të menaxhohen në mënyrë të koordinuar.

5. Lidhja e certifikatave me natyrën konkrete të objektit

Kërkesat për katër certifikatat nuk janë përcaktuar në mënyrë të shkëputur nga objekti i kontratës, por lidhen me katër aspekte kryesore të realizimit të saj:

Certifikimi Nevoja konkrete në objekt

ISO 9001	Kontrolli dhe garantimi i cilësisë së punimeve të gërmimit, shtresave, betonit, betonarmesë, muraturës, veprave të artit, kanalizimeve dhe strukturave
ISO 14001	Menaxhimi i ndikimit mjedisor nga shpyllëzimi, gërmimet, mbetjet, pluhuri, zhurmat, makineritë dhe ndërhyrjet në terren natyror
ISO 45001	Menaxhimi i rreziqeve nga makineritë, gërmimet, punimet në lartësi, betoni, montimet, transporti dhe puna në terren
PAS 99:2012	Integrimi i sistemeve të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë/shëndetit në një qasje të koordinuar të menaxhimit

Në këtë mënyrë, secila certifikatë mbulon një aspekt të ndryshëm dhe të rëndësishëm të zbatimit të kontratës.

Kërkesa që certifikatat të jenë të vlefshme në datën e paraqitjes së ofertës është e nevojshme për të siguruar që operatori ekonomik, në momentin e pjesëmarrjes në procedurë, disponon sistemet e menaxhimit që kërkohen për realizimin e kontratës. Kjo shmang situatat në të cilat paraqitet një certifikatë e skaduar ose një dokument që nuk dëshmon ekzistencën aktuale të sistemit të menaxhimit. Kërkesa që certifikatat të jenë lëshuar nga organe certifikuese të akredituara nga DPA ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë synon të garantojë besueshmërinë, vlefshmërinë dhe verifikueshmërinë e dokumenteve të paraqitura. Kjo

është e nevojshme për të shmangur paraqitjen e dokumenteve të lëshuara nga subjekte që nuk kanë kompetencën apo akreditimin e nevojshëm për certifikimin e sistemeve të menaxhimit. Kërkesa për ekuivalencën e certifikatave siguron që operatorët ekonomikë që disponojnë sisteme të tjera të barasvlershme të mos përjashtohen vetëm për shkak të ndryshimit të emërimit apo standardit të certifikimit, për sa kohë që ekuivalenca mund të provohet sipas kërkesave të zbatueshme.

Objekti parashikon angazhimin e një numri të konsiderueshëm punonjësish dhe përdorimin e një numri të madh mjetesh e pajisjesh. Në këto kushte, operatori ekonomik duhet të jetë në gjendje të menaxhojë në mënyrë të koordinuar fuqinë punëtore, makineritë dhe pajisjet, materialet, proceset teknologjike, cilësinë e punimeve, mbetjet dhe aspektet mjedisore, sigurinë dhe shëndetin në punë dhe situatat e emergjencës.

Pikërisht për këtë arsye, kërkesa për sisteme të standardizuara menaxhimi lidhet me nevojën që realizimi i kontratës të mos varet vetëm nga eksperiencia individuale e personelit, por të mbështetet në procedura dhe sisteme të dokumentuara menaxhimi.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike, relacioni teknik, preventivi i punimeve, vizatimet teknike, profilet karakteristike, detajet konstruktive dhe grafiku i ekzekutimit të punimeve për objektin “NDËRTIMI I SHTEGUT TË ÇEZARIT” janë hartuar nga projektuesi i licencuar, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, aktet nënligjore në fuqi për projektimin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit, standardet teknike shqiptare dhe europiane, si dhe rregullat e praktikës së mirë inxhinierike.

Objekti i investimit konsiston në ndërtimin, sistemimin dhe funksionalizimin e Shtegut të Çezarit, nëpërmjet realizimit të një sërë ndërhyrjesh infrastrukturore, konstruktive, funksionale dhe mjedisore, me qëllim krijimin e një shtegu të qëndrueshëm, të sigurt dhe funksional për përdoruesit, përmirësimin e aksesit, sistemimin e terrenit dhe garantimin e qëndrueshmërisë së elementeve konstruktive dhe infrastrukturore përgjatë gjurmës së shtegut.

Hartimi i dokumentacionit teknik është mbështetur në karakteristikat fizike dhe topografike të terrenit, gjendjen ekzistuese të zonës dhe nevojën për krijimin e një traseje të sistemuar dhe të qëndrueshme, duke marrë në konsideratë ndërhyrjet e nevojshme për pastrimin dhe përgatitjen e terrenit, gërmimet, punimet e dheut, ndërtimin e shtresave, realizimin e elementeve prej betoni dhe betonarmeje, mureve prej guri, veprave të artit, kanalizimeve, strukturave prej druri, elementeve të sinjalistikës dhe tabelave informuese.

Dokumentacioni teknik përcakton mënyrën e realizimit të proceseve të punës, parametrat teknikë, materialet, dimensionet, kuotat, profilet, detajet konstruktive dhe kërkesat që duhet të respektohen gjatë zbatimit të kontratës, në mënyrë që shtegu të realizohet në përputhje me projektin dhe me kërkesat për siguri, qëndrueshmëri dhe funksionalitet.

Referuar preventivit të punimeve, në fazat fillestare të realizimit të objektit janë parashikuar punime shpyllëzimi, pastrimi dhe përgatitjeje të terrenit përgjatë gjurmës së shtegut. Këto punime janë të nevojshme për krijimin e kushteve të përshtatshme për hapjen dhe sistemimin e gjurmës së shtegut, realizimin e gërmimeve dhe vendosjen e shtresave dhe elementeve konstruktive të parashikuara në projekt.

Ndërhyrjet në bimësi dhe në terren duhet të realizohen në mënyrë të kontrolluar, duke kufizuar ndërhyrjet vetëm në sipërfaqet e përcaktuara nga projekti dhe duke ruajtur, sa më shumë të jetë e mundur, elementet natyrore që nuk pengojnë realizimin e veprës.

Një komponent kryesor i objektit përbëhet nga punimet e gërmimit dhe punimet e dheut, të cilat janë të nevojshme për krijimin e gjurmës së shtegut, realizimin e kuotave të projektit dhe përgatitjen e bazamentit për shtresat dhe elementet konstruktive. Gërmimet duhet të kryhen në mënyrë të kontrolluar, duke respektuar gjurmën, kuotat, profilet gjatësore dhe tërthore dhe dimensionet e përcaktuara në projekt, si dhe duke shmangur ndërhyrjet e panevojshme në terrenin përreth. Materialet e rezultuara nga gërmimet duhet të menaxhohen në përputhje me projektin, duke përfshirë ngarkimin, transportin, sistemimin, ripërdorimin ose largimin e tyre sipas përcaktimeve teknike. Punimet e dheut përfshijnë gjithashtu mbushjen, sistemimin, sheshimin dhe përgatitjen e bazamentit të shtegut, me qëllim krijimin e një sipërfaqeje të qëndrueshme dhe të përshtatshme për realizimin e shtresave të mëvonshme.

Punimet e shtresave janë parashikuar për krijimin e një bazamenti të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm për përdorimin e shtegut. Materialet e shtresave duhet të vendosen dhe shpërndahen në trashësitë dhe kuotat e përcaktuara në projekt, të nivelohen dhe të ngjeshen sipas kërkesave teknike. Realizimi korrekt i shtresave është i domosdoshëm për të siguruar qëndrueshmërinë, drenazhimin, rezistencën ndaj ngarkesave dhe jetëgjatësinë e shtegut, duke marrë në konsideratë edhe kushtet e terrenit dhe ekspozimin ndaj faktorëve atmosferikë.

Në kuadër të projektit janë parashikuar punime betoni dhe betonarmeje, të cilat përdoren për realizimin e elementeve konstruktive dhe infrastrukturore të nevojshme për funksionimin dhe stabilitetin e shtegut. Punimet përfshijnë përgatitjen, vendosjen dhe përpunimin e betonit, si dhe realizimin e elementeve të betonarmës sipas dimensioneve, kuotave dhe detajeve konstruktive të projektit. Përgatitja dhe vendosja e betonit duhet të kryhen në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e projektit, duke garantuar rezistencën, qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e elementeve të realizuara.

Një komponent i rëndësishëm i objektit është ndërtimi i veprave të artit dhe kanalizimeve, të cilat janë të nevojshme për funksionimin e shtegut dhe menaxhimin e ujërave përgjatë tij. Këto elemente kanë për qëllim drejtimin, kalimin dhe largimin e ujërave, si dhe mbrojtjen e trupit të shtegut nga dëmtimet që mund të shkaktohen nga ujërat sipërfaqësore dhe reshjet atmosferike. Realizimi i veprave të artit dhe kanalizimeve duhet të bëhet sipas kuotave, seksioneve, dimensioneve dhe detajeve konstruktive të përcaktuara në projekt, duke garantuar funksionimin hidraulik dhe qëndrueshmërinë e tyre.

Në preventiv janë parashikuar punime murature prej guri, të cilat kanë rol konstruktiv, mbrojtës dhe sistemues përgjatë segmenteve të përcaktuara të shtegut. Muret prej guri janë të nevojshme për stabilizimin e terrenit, mbajtjen e masave të dheut, mbrojtjen e trupit të shtegut dhe krijimin e një zgjidhjeje të përshtatshme me karakterin natyror të zonës. Muratura duhet të realizohet sipas dimensioneve, lartësive, kuotave, seksioneve dhe detajeve të projektit, duke garantuar lidhjen, qëndrueshmërinë dhe rezistencën e strukturës. Përdorimi i gurit në këto elemente synon gjithashtu që ndërhyrjet konstruktive të jenë të përshtatshme me karakterin dhe peizazhin e zonës ku zhvillohet shtegu.

Në preventiv janë parashikuar edhe punime hidroizolimi dhe çatie, të cilat lidhen me elementet dhe strukturat e parashikuara në projekt. Hidroizolimi synon mbrojtjen e elementeve konstruktive nga depërtimi i ujit dhe lagështisë, duke kontribuar në rritjen e jetëgjatësisë së tyre. Punimet e

çatisë duhet të realizohen sipas zgjidhjeve teknike, pjerrësive, detajeve të mbulimit dhe mënyrës së largimit të ujërave të përcaktuara në projekt.

Një element karakteristik i objektit janë strukturat prej druri, të parashikuara për realizimin e elementeve funksionale dhe arkitektonike të shtegut. Këto struktura duhet të realizohen sipas dimensioneve, seksioneve, mënyrës së lidhjes, ankorimit dhe detajeve konstruktive të përcaktuara në projekt. Materiali i drurit duhet të jetë i përshtatshëm për përdorim në ambient të jashtëm dhe të trajtohet në mënyrë që të sigurohet rezistenca ndaj lagështirës, faktorëve atmosferikë, dëmtimit biologjik dhe degradimit në kohë.

Për garantimin e funksionalitetit dhe orientimit të përdoruesve të shtegut janë parashikuar tabela informuese, panele plotësuese sinjalistike, si dhe dizajnimi dhe realizimi i tabelave dhe paneleve. Këto elemente kanë për qëllim orientimin e përdoruesve, identifikimin e pikave të ndryshme përgjatë shtegut, dhënien e informacionit të nevojshëm dhe rritjen e sigurisë gjatë përdorimit. Tabela dhe panelet duhet të realizohen sipas përmasave, materialeve, grafikës, përmbajtjes dhe mënyrës së fiksimit të përcaktuar në dokumentacionin teknik. Sinjalistika duhet të jetë e qartë, e lexueshme dhe e përshtatshme për kushtet e përdorimit në ambient të jashtëm.

Në preventiv janë parashikuar punime pastrimi dhe dezinfektimi, të cilat janë të nevojshme për përgatitjen dhe përfundimin e zonave të ndërhyrjes dhe për garantimin e kushteve të përshtatshme të përdorimit. Pastrimi përfshin largimin e materialeve të panevojshme, mbetjeve të punimeve dhe elementeve që pengojnë përdorimin normal të shtegut. Dezinfektimi do të kryhet në zonat dhe në mënyrën e përcaktuar nga dokumentacioni teknik, duke përdorur materiale të përshtatshme dhe në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë.

Në kuadër të objektit janë parashikuar punime për pastrimin nga gurët dhe sistemimin e shtegut, të cilat janë të rëndësishme për krijimin e një traseje të sigurt dhe të përdorshme. Punimet përfshijnë largimin e gurëve dhe materialeve që pengojnë kalimin, sistemimin e sipërfaqes, sheshimin dhe përmirësimin e gjurmës së shtegut në përputhje me profilet dhe kuotat e projektit. Këto ndërhyrje synojnë të krijojnë një sipërfaqe sa më të qëndrueshme dhe të përshtatshme për përdoruesit, duke ruajtur njëkohësisht karakterin natyror të zonës.

Në preventiv është parashikuar edhe mirëmbajtja vjetore, e cila synon ruajtjen e funksionalitetit dhe gjendjes së mirë të shtegut dhe elementeve përbërëse të tij pas përfundimit të punimeve. Mirëmbajtja lidhet me kontrollin dhe ndërhyrjet e nevojshme për sistemimin e shtegut, pastrimin, largimin e materialeve të akumuluar, kontrollin e elementeve të sinjalistikës, strukturave dhe komponentëve të tjerë të realizuar në kuadër të projektit. Kjo fazë është e rëndësishme për të garantuar që investimi të ruajë funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e tij gjatë periudhës së përdorimit.

Çdo zë i preventivit është përcaktuar mbi bazën e projektit teknik dhe matjeve përkatëse, duke specifikuar sasinë, njësinë e matjes, procesin e punës dhe karakteristikat e materialeve që do të përdoren. Preventivi përfshin në mënyrë të integruar punimet e përgatitjes së terrenit, gjurmimit, punimet e dheut, shtresat, betonin dhe betonarmën, veprat e artit dhe kanalizimet, muraturën e gurit, hidroizolimet, çatitë, strukturat prej druri, sinjalistikën dhe tabelat, pastrimet, sistemimin e shtegut dhe mirëmbajtjen vjetore. Preventivi përbën bazën ekonomike të procedurës së prokurimit dhe u mundëson operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre mbi një bazë të njëjtë teknike dhe financiare, duke garantuar krahasueshmërinë e ofertave.

Specifikimet teknike përcaktojnë kërkesat minimale për materialet dhe elementet që do të përdoren në realizimin e objektit. Materialet, duke përfshirë materialet e shtresave, betonin, hekurin për betonarme, gurin për muraturë, materialet hidroizoluese, elementet prej druri, elementet e sinjalistikës, tabelat, panelet dhe materialet për kanalizime, duhet të jenë të përshtatshme për përdorimin e parashikuar dhe të plotësojnë kërkesat teknike dhe dokumentacionin përkatës të konformitetit dhe cilësisë.

Vizatimet teknike, profilet karakteristike dhe detajet konstruktive janë hartuar me një nivel të përshtatshëm detajimi për të mundësuar interpretimin e njëjtë të punimeve nga operatorët ekonomikë dhe personeli përgjegjës për zbatimin dhe kontrollin e tyre. Dokumentacioni përcakton, sipas rastit, gjurmën e shtegut, kuotat, profilet gjatësore dhe tërthore, nivelet e gjurmimit dhe mbushjes, shtresat konstruktive, dimensionet e mureve prej guri, elementet e betonit dhe betonarmesë, veprat e artit, kanalizimet, strukturat prej druri dhe pozicionet e tabelave dhe sinjalistikës. Përcaktimi i saktë i kuotave, pjerrësive, niveleve, trashësive të shtresave dhe dimensioneve të elementeve konstruktive është i domosdoshëm për garantimin e qëndrueshmërisë, sigurisë, funksionalitetit dhe jetëgjatësisë së shtegut.

Grafiku i ekzekutimit të punimeve është hartuar duke marrë në konsideratë varësinë teknologjike ndërmjet proceseve të ndryshme të punës. Në mënyrë të përgjithshme, punimet parashikohet të fillojnë me përgatitjen dhe pastrimin e terrenit dhe punimet e shpyllëzimit, të vijojnë me gjurmimet dhe punimet e dheut, pastrimin dhe sistemimin e gjurmës, realizimin e shtresave dhe elementeve të nevojshme konstruktive, ndërtimin e veprave të artit dhe kanalizimeve, realizimin e mureve prej guri dhe elementeve prej betoni e betonarmeje, dhe më pas me realizimin e strukturave prej druri, hidroizolimeve, çative, sinjalistikës, tabelave dhe paneleve. Në fazat përfundimtare parashikohen pastrimi, dezinfektimi, pastrimi nga gurët, sistemimi dhe sheshimi i shtegut, duke vijuar me ndërhyrjet e parashikuara në kuadër të mirëmbajtjes vjetore. Kjo renditje synon të sigurojë vijueshmërinë teknologjike të punimeve, të shmangë ndërhyrjet e panevojshme ndërmjet proceseve dhe të krijojë kushtet për realizimin e çdo faze në përputhje me projektin dhe brenda afatit kontraktor.

Dokumentacioni teknik është hartuar në mënyrë që të sigurojë një kuptim të plotë dhe të njëjtë të objektit të prokurimit nga të gjithë operatorët ekonomikë, duke shmangur paqartësitë dhe interpretimet subjektive. Specifikimet teknike janë formuluar mbi baza objektive, funksionale dhe të lidhura me nevojat reale të objektit, pa synuar favorizimin e ndonjë operatori ekonomik, marke apo prodhuesi të caktuar. Në çdo rast kur në dokumentacionin teknik përmendet ndonjë standard, produkt ose karakteristikë specifike, ajo duhet të kuptohet e shoqëruar me shprehjen “ose ekuivalente”, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Hartimi i dokumentacionit teknik është bërë në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe me nenin 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, duke respektuar kërkesat për qartësinë, objektivitetin dhe proporcionalitetin e specifikimeve teknike dhe duke garantuar akses të barabartë për operatorët ekonomikë.

Njëkohësisht, dokumentacioni teknik është hartuar duke respektuar parimet e përcaktuara në nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, përkatësisht transparencën, proporcionalitetin, trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, konkurrencën efektive dhe përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve publike.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se specifikimet teknike, preventivi, relacioni teknik, vizatimet, profilet, detajet konstruktive dhe grafiku i ekzekutimit të punimeve për objektin “NDËRTIMI I SHTEGUT TË ÇEZARIT” përbëjnë një dokumentacion teknik të plotë dhe të mjaftueshëm për zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe realizimin e punimeve.

Dokumentacioni përcakton në mënyrë të qartë punimet e shpyllëzimit dhe përgatitjes së terrenit, gërmimet, punimet e dheut, shtresat, punimet e betonit dhe betonarmesë, ndërtimin e veprave të artit dhe kanalizimeve, muraturën prej guri, hidroizolimet dhe çatitë, strukturat prej druri, tabelat informuese dhe panelet e sinjalistikës, punimet e pastrimit dhe dezinfektimit, pastrimin nga gurët, sistemimin dhe sheshimin e shtegut, si dhe mirëmbajtjen vjetore.

Nëpërmjet këtij dokumentacioni synohet garantimi i realizimit të Shtegut të Çezarit me cilësinë, sigurinë, qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e kërkuar, duke ruajtur dhe integruar sa më mirë ndërhyrjen infrastrukturore me karakteristikat e terrenit dhe mjedisit përreth, si dhe duke garantuar përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve publike, në funksion të interesit publik dhe të qëllimit të investimit.

NJËSIA E PROKURIMIT